



MINISTRIA E SHËNDETËSISË

# STRATEGJIA AFATGJATE E ZHVILLIMIT TE SISTEMIT SHENDETESOR SHQIPTAR Prill 2004

MBËSHTETUR NGA  
ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË – ZYRA E VENDIT – SHQIPËRI,  
FINANCUAR NGA DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM NDERKOMBËTAR I BRITANISË SË MADHE DHE QEVERIA ITALIANE



**DFID**  
Department for  
International Development





# Struktura e materialit

Mirenjohje.....	4
Paratenie.....	5
Hyrje.....	7
<b>1. Drejtimi dhe rregullimi.....</b>	<b>8</b>
1.1.1 Situata.....	8
1.1.2 Problemet.....	8
1.1.3 Objektivi.....	9
1.1.4 Strategjite.....	9
<b>1.2 Akreditimi.....</b>	<b>11</b>
1.2.1 Akreditimi institucional.....	11
1.2.2 Akreditimi individual.....	11
1.2.3 Situata e problemet.....	11
1.2.4 Objektivi.....	12
1.2.5 Strategjite.....	12
<b>1.3 Organizatat partnere.....</b>	<b>12</b>
1.3.1 Situata.....	12
1.3.2 Problemet.....	12
1.3.3 Objektivi.....	13
1.3.4 Strategjite.....	13
<b>1.4 Aktiviteti i sektorit privat.....</b>	<b>13</b>
1.4.1 Situata.....	13
1.4.2 Problemet.....	13
1.4.3 Objektivi.....	14
1.4.3 Strategjite.....	14
1.5 Roli i pacientit.....	14
1.5.1 Situata.....	14
1.5.2 Problemet.....	15
1.5.3 Objektivi.....	15
1.5.4 Strategjite.....	15
<b>2. Organizimi dhe decentralizimi.....</b>	<b>15</b>
2.1.1 Situata.....	15
2.1.2 Problemet.....	16
2.1.3 Objektivi.....	17
2.1.4 Strategjite.....	17
<b>3. Burimet njerezore.....</b>	<b>18</b>
3.1.1 Situata.....	18
3.1.2 Problemet.....	20

3.1.3	Objektivi.....	21
3.1.4	Strategjite.....	21
<b>4.</b>	<b>Financimi.....</b>	<b>23</b>
4.1.1	Situata.....	23
4.1.2	Problemet.....	25
4.1.3	Objektivi.....	25
4.1.4	Strategjite.....	25
<b>5.</b>	<b>Menaxhimi.....</b>	<b>27</b>
5.1.1	Situata.....	27
5.1.2	Problemet.....	29
5.1.3	Objektivi.....	30
5.1.4	Strategjite.....	30
<b>6.</b>	<b>Sherbimet shendetesore.....</b>	<b>31</b>
<b>6.1</b>	<b>Shendetit publik.....</b>	<b>31</b>
6.1.1	Situata.....	31
6.1.2	Problemet.....	32
6.1.3	Objektivi.....	32
6.1.4	Strategjite.....	32
<b>6.2</b>	<b>Kujdesi shendetesor paresor.....</b>	<b>33</b>
6.2.1	Situata.....	33
6.2.2	Problemet.....	34
6.2.3	Objektivi.....	36
<b>6.3</b>	<b>Sherbimet e kujdesit shendetesor spitalor.....</b>	<b>38</b>
6.3.1	Situata.....	38
6.3.2	Problemet.....	41
6.3.3	Objektivi.....	41
6.3.4	Strategjite.....	41
<b>6.4</b>	<b>Sherbimi stomatologjik.....</b>	<b>44</b>
6.4.1	Situata.....	44
6.4.2	Problemet.....	44
6.4.3	Zgjidhjet e propozuara:.....	45
<b>6.5</b>	<b>Sherbimi farmaceutik.....</b>	<b>45</b>
6.5.1	Situata.....	45
6.5.2	Problemet.....	46
6.5.3	Objektivi.....	47
6.5.4	Strategjite.....	47
<b>7</b>	<b>Suksesi i reformes.....</b>	<b>47</b>

# Abbreviations and Acronyms

<b>CEE</b>	Central Eastern Europe
<b>CPD</b>	Continual Professional Development
<b>EU</b>	European Union
<b>FD</b>	Family Doctors
<b>FM</b>	Family Medicine
<b>GoA</b>	Government of Albania
<b>GPs</b>	General Practitioners
<b>HI</b>	Health Insurance
<b>HII</b>	Health Insurance Institute
<b>HS</b>	Hospital Service
<b>LTSDAHS</b>	Long Term Strategy for the Development of the Albanian Health System
<b>MoES</b>	Ministry of Educational Services
<b>MoF</b>	Ministry of Finance
<b>MoH</b>	Ministry of Health
<b>NIS</b>	New Independent States
<b>NSSED</b>	National Strategy for Socio-economic Development
<b>OPA</b>	Order of Physicians of Albania
<b>PH</b>	Public Health
<b>PHC</b>	Primary Health Care
<b>PHRplus</b>	Primary Healthcare Reform (USAID funded programme)
<b>PS</b>	Pharmaceutical Services
<b>RHA</b>	Regional Health Authority
<b>SHC</b>	Secondary Healthcare (hospital sector)
<b>SI</b>	Social Insurance
<b>TRHA</b>	Tirana Regional Health Authority
<b>UoM</b>	University of Medicine
<b>USAID</b>	USA International Development
<b>WB</b>	World Bank
<b>WHO</b>	World Health Organization

# Mirënjohje

Strategjia Afatgjate e Zhvillimit te Sistemit Shendetesor u perqatit nga Ministria e Shendetesise e Republikes se Shqiperise nen drejtimin e Zevendes Ministrit Dr. Eduart Hashorva.

Nje kontribut shume te rendesishem ne hartimin e ketij dokumenti ka dhene konsulenti i Bankes Boterore Dr. Besim Nuri.

Draft Dokumenti Strategjik i Reformes 10 vjecare te Zhvillimit te Sistemit Shendetesor hartuar nen drejtimin e konsulentit te EHO, Dr. Antonio Duran eshte perdonur si literature me mjaft vlere.

Me komentet, sugjerimet dhe inkurajimin e tyre, nje ndihmese te vecante kane dhene Organizata Boterore e Shendetesise (EHO) (Dr. S. Severon dhe Z. D. Teylor), Banka Boterore (EB) (Znj. M. Huppi dhe Z. N. Muhammed), dhe Projekti URC, Agjensia e Shteteve te Bashkuara per Zhvillimin Nderkombetar (USAID) (Dr. V. Boguslavsky, Dr. R. Rhyne, Znj. Ch. Hjortsberg, Dr. E. Dasho, Znj. F. Hobdari).

Nje numer profesionistesh te shendetesise moren pjese aktivisht ne procesin e hartimin dhe/ose diskutimit duke dhene nje kontribut me vlere ne permiresimin e kesaj strategje:

<b>Saemira Pino</b>	– Zevendes Ministre e Shendetesise - Doktore e Shkencave
<b>Dr. Petro Mersini</b>	– Drejtore i Kabinetit te Ministrit te Shendetesise
<b>Sokol Dedja</b>	– Keshilltar i Ministrit te Shendetesise
<b>Dr. Jeta Lakrori</b>	– Keshilltare e Ministrit te Shendetesise
<b>Lindita Backa</b>	– Drejtore e Drejtorisë se Politikave, MSh - MSc
<b>Thanas Poci</b>	– Drejtore i Drejtorisë Ekonomike, MSh
<b>Auron Cara</b>	– Drejtore i Drejtorisë se Burimeve Njerezore, MSh
<b>Arjan Jaupllari</b>	– Drejtore i Drejtorisë Farmaceutike, MSh
<b>Dr. Agim Shehi</b>	– Drejtore i Drejtorisë se KSh Paresor, MSh – Dr. i Shkencave
<b>Dr. Fatmir Brahimi</b>	– Drejtore i Drejtorisë Spitalore, MSh
<b>Durim Kraja</b>	– Drejtore i Drejtorisë se Auditimit, MSH
<b>Dr. Nurie Caushi</b>	– Drejtore e Drejtorisë se Informacionit, MSh
<b>Dr. Silva Bino</b>	– Drejtore e Institutit te Shendetit Publik – PhD, MD
<b>Dr. Enkejleda Pellumbi</b>	– Shefe e Sektorit te Stomatologjise, MSH

**Leonard Solis**  
Minister i Shendetesise se Republikes se Shqiperise  
Tirane me 15/07/2004

## Parathënie

Eshe nje kenaqesi e vecante per mua te prezantoj Strategjine Afatgjate te Zhvillimit te Sistemit Shendetesor Shqipetar, kete dokument te rendesishem qe i ka munguar kaq gjate Ministrise sone.

Ne kete dokument eshte analizuar ne menyre te permbledhur e te qarte situata aktuale e sistemit shendetesor dhe eshte shprehur vizioni yne per reformimin e tij te thelle, te bazuar ne modelet e pervojet e suksesshme bashkekohore. Zbatimi i ketyre modeleve kerkon ndryshimin e mekanizmave baze te organizimit, financimit e menaxhimit per te bere te mundur realizimin e objektivit tone final; "Sigurimin dhe permiresimin e vazhdueshem te kujdesit shendetesor per popullaten".

Kjo strategji bashkohore e ambicioze paraqet sfidat qe duhen perballuar:

- Forcimi i kapaciteve teknike te Ministrise se Shendetesise per hartimin e politikave, strategjive apo planeve kombetare te zhvillimit te sistemit shendetesor duke iu shmangur gradualisht rolit tradicional te menaxhimit direkt te sherbimeve shendetesore.
- Permiresimi i politikave stimuluese per sherbimin shendetesor privat, si dhe forcimi i ligjshmerise, standardeve, strukturave kontrolluese e monitoruese ndaj tij per te mbrojtur shendetin e popullates nga abuzimet e praktikat e demshme.
- Vendosja e patientit ne qender te sistemit shendetesor si kusht thelbesor per sherbim cilesor e zhvillim.
- Decentralizimi i sistemit shendetesor me synim perfundimtar autonomine e tij, si zgjidhje optimale per miremenaxhim e ruajtje te integritetit te sistemit.
- Krijimi i nje sistemi kombetar te burimeve njerezore shendetesore - i afte te realizoje misionin e tij.
- Zgjerimi i bases se burimeve financiare, rritja e mases se financimit dhe kosto-efiktivitetit te perdonimit te tyre nepermjet shtimit te fondeve publike per shendetesine, zgjerimt dhe forcimit te skemes se sigurimeve shendetesore, permiresimit te mekanizmave te kontraktimit, permiresimit te menaxhimit etj.
- Forcimi i kapaciteve menaxheriale te institucioneve shendetesore nepermjet krijimit te modeleve bashkekohore te menaxhimit te tyre, krijimit te profesionit te menaxhereve te shendetesise etj.

- Ruajtja dhe permiresimi i shendetit publik duke iu pershtatur ndryshimeve ekonomike, shoqerore dhe epidemiologjik te vendit.
- Forcimi e persosja e sherbimit shendetesor paresor duke e vleresuar ate si hallken kryesore te sherbimeve shendetesore.
- Krijimi i modelit te spitalit autonom me synim permiresimin e menaxhimit dhe rritjen e cilesise se sherbimit.
- Permiresimi rrenjesor i sherbimit dentar e farmaceutik me synim standartizimin e forcimin e strukturave monitoruese e kontrolluese.

Shpreh bindjen qe zbatimi i suksesshem i kesaj strategje do te permiresoje dukshem organizimin dhe funksionimin e sistemin tone shendetesor, duke e transformuar ate ne nje sistem bashkekohor te krahasueshem me ate te vendeve te zhvilluara europiane.

Suksesi i realizimit te reformes tashme te filluar, kerkon domosdoshmerisht jo vetem perkushtimin e profesionisteve te sistemit shendetesor, por edhe mirekuptimin dhe mbeshtetjen e popullates, konsensusin e gjere, vullnet te plote politik, vazhdimesine etj.

**Leonard Solis**  
Minister i Shendetesise se Republikës së Shqipërisë  
Tirane me 15/07/2004

Ky dokument paraqet vizionin e Ministrise se Shendetesise te Republikës së Shqipërisë per zhvillimin afatgjate te Sistemit Shendetesor te vendit dhe eshte ne harmoni te plote me objektivat sektoriale te “Strategjise Kombetare te Zhvillimit Ekonomik e Social” te Qeverise Shqiptare dhe Objektivat e Mijevjecarit.

Per hartimin e saj jane patur parasysh Komunikat e Komisionit te BE e dates 16 maj 2000, “Per Strategjine ne fushen e Shendetesise per Komuniteten European”, per zbatimin e parimeve te integritetit, qendrueshmerise dhe perqendrimit ne problemet kryesore si edhe vendimi Nr. 1786/2002/KE date 23.11.2002 i Komisionit, Keshillit dhe Parlamenti i BE per miratimin e “Programit te Veprimit te Komunitetit ne fushen e Shendetit Publik”.

Hartimi ikesaj strategjia u mundesua nga asistencia teknike e ofruar nga Organizata Boterore e Shendetesise dhe Banka Boterore, si dy partneret kryesore te Ministrise se Shendetesise

## Hyrje

Nje sistem shendetesor ideal do te ishte ai sistem qe eshte i afte te ofroje sherbimin shendetesor baze, lehtesish te arritshem e cilesisht te pranueshem per popullaten dhe me eficiece te larte.

Synimi kryesor i kesaj strategie eshte reformimi i thelle i sistemit shendetesor aktual duke u bazuar ne modelet e pervojet me te sukseshme bashkekohore, implementimi i te cilave kerkon ndryshimin e mekanizmat baze te organizimit, financimit e menaxhimit duke bere te mundur realizimin e objektivit final;

### **“SIGURIMIN DHE PERMIRESIMIN E VAZHDUESHEM TE KUJDESIT SHENDETESOR PER POPULLATEN”.**

Teknikisht, analiza e sistemit shendetesor eshte realizuar nga dy kendveshtrime; horizontal ose sipas elementeve baze qe jane:

- Drejtimi dhe Rregullimi,
- Organizimi dhe Decentralizimi,
- Burimet Njerezore
- Financimi,
- Menaxhimi

dhe kendveshtri vertikal ose struktural, sipas sherbimeve funksionale te sistemit shendetesor qe jane:

- Shendetet Publik,
- Kujdesi Shendetesor Paresor,
- Kujdesi Shendetesor Spitalor,
- Sherbimi Dentar,
- Sherbimi Farmaceutik.

Kjo strategji sintetizon elementet baze te organizimit e funksionimit te sistemit shendetesor. Per te krijuar nje pamje me te thelluar ne drejtime te vecanta rekomandohen te konsultohen dokumentat strategjike te ketyre drejtimeve si:

- “Dokumenti i Politikes se Shendetit Mendor ne Shqiperi” - 2003,
- “Strategja e Shendetit Publik dhe te Promocionit Shendetesor” – 2003, Ligji per Sherbimin Spitalor ne Republiken e Shqiperise – 2003,
- “Strategja Kombetare per Parandalimin dhe Kontrollin e HIV/AIDS-it” – 2004, etj.



# Drejtimi dhe rregullimi

## 1

### 1.1.1 Situata

Synimi i ministrise se shendetesise ka qene orjentimi drejt funksionit te hartimit te politikave, strategjive dhe planeve kombetare te zhvillimit te sistemit shendetesor duke ju shmangur gradualisht rolit tradicional te “drejtorise se shendetesise” pra, menaxhimit direkt te sherbimeve shendetesore. Kjo materializohet edhe nga fakti i hartimit te nje sere dokumentash te rendesishme te politikave e strategjive kombetare te shendetit si:

Strategja E Shendetit Mendor (2003),  
Strategja E Shendetit Publik Dhe E Promocionit Shendetesor (2003),  
Masterplani I Zhvillimit Te Qendres Spitalore Universitare “Nene Tereza” Te Tiranes (2003),  
Ligi Per Sherbimin Spitalor Ne Republiken E Shqiperise – 2003,  
Strategja Per Parandalimin Dhe Kontrollin E Hiv/aids (2004) Etj.

Ketij synimi i kane sherbyer edhe nje numer ndryshimesh te rendesishme ne strukturen organizative te ministrise se shendetesise si krijimi i

1. Drejtorise Se Politikave Dhe Planifikimit
2. Njesise Se Monitorimit Dhe Vleresimit Etj.

### 1.1.2 Problemet

Ministria e shendetesise zoteron kapacitete te kufizuara tekniqe per hartimin e politikave, strategjive apo planeve kombetare pasi politikat stimuluese te derisotme te terheqjes se profesionisteve te zote te ketyre fushave kane rezultuar joefektive.

Organizimi dhe struktura e ministrise se shendetesise kerkojne permiresim te metejshem per realizimin e perjegjesive dhe detyrave te reja si;

- Ne fushen e politikave te skemave te sigurimeve shendetesore,
- Te shendetit mendor,
- Te menaxhimit shendetesor e kontrollit te cilesise se sherbimit,
- Te akreditimit,
- Te licensimit,
- Kontrollit e monitorimit te aktivitetit privat,
- Edukimit te vazhdueshem,
- Te standartizimit dhe mirembajtjes se aparaturave dhe pajisjeve mjekesore etj.

Te cilat pengohen me justifikimin e mosrritjes se numurit te personelit.

### **1.1.3 Objektivi**

Do te forcojme kapacitetet per hartimin e politikave, strategjive dhe planeve kombetare te ministrise se shendetesise.

### **1.1.4 Strategjite**

- a. Do te realizohet ristrukturimi i ministrise se shendetesise me synimin forcimin e kapaciteteve politikberese duke krijuar e plotesuar strukturat e nevojshme ne fushen e politikave te sigurimeve shendetesore, te shendetit mendor, te menaxhimit shendetesor e kontrollit te cilesise se sherbimit, te akreditimit, te licensimit, kontrollit e monitorimit te aktivitetit privat, edukimit te vazhdueshem, te standartizimit dhe mirembajtjes se aparaturave dhe pajisjeve mjekesore etj.
- b. Do te fuqizohet njesia e monitorim/vleresimit, e cila do te jete syri vezhguar i zhvillimeve brenda sistemit shendetesor dhe do te kontribuoje ndjeshem ne orientimin e strategjive dhe aktiviteteve. Per kete qellim, do te perpunohet nje model funksionimi i njesise se monitorimit dhe vleresimit me ndihmen e partnereve te huaj (brenda vitit 2004).
- c. Do te forcohen kapacitetet per hartimin e planeve kombetare strategjike. Keto plane do te jene 3-vjecare dhe do te rishihen vit pas viti me qellim qe te shtohen elemente te rinj, te cilet te pasqyrojn ndryshimet e krijuara. Planet tre-vjecare do te sherbejne per disa qellime:
  1. Te orientojne hartimin e planeve shendetesore ne nivel lokal (qarku);
  2. Te orientojne sa me drejt investimet e medha ne sektorin e shendetesise, ne varesi te perparese te percaktuara;
  3. Te monitorojne e vleresojne prirjet e zhvillimeve si edhe zbatimin e programeve brenda sistemit shendetesor;
  4. Te sigurojne nje zhvillim te matshem dhe te dukshem te sektorit shendetesor.
- d. Do te hartohet nje plan i pare kombetar tre-vjecar (2005-2008) i zhvillimit te sektorit te shendetesise, duke filluar nga viti 2005. Kjo do te beje te mundur ndertimin e nje modeli planifikimi shendetesor ne nivel kombetar. Hartimi i nje buxheti realist do te jete pjesa e rendesishme perberese e procesit te planifikimit, me qellim qe te arrihet nje nderthurje racionale e objektivave shendetesore me burimet financiare. Pjesa e rendesishme e planit do te jene gjithashtu edhe udhezuesit per hartimin e planeve shendetesore te qarqeve. Stafi teknik i ministrise se shendetesise do te trajnohet dhe do te aftesohet me qellim qe t'u jape mbeshtetje teknike niveleve te qarkut per hartimin e planeve shendetesore te ketij niveli.
- e. Do te perfundoje plani kombetar i zhvillimit te spitaleve brenda vitit 2004, ne vijim te zbatimit te ligjit te ri te spitaleve. Ky plan do te percaktoje qarte se cilet do te jene spitalet e rretheve, cilet do te jene spitalet e qarqeve si edhe cfare sherbimesh do te ofroje secili prej ketyre niveleve spitalore, ne varesi te nevojave dhe perparese te zonave gjeografike dhe popullsive qe do te mbulojne. Plani spitalor do te parashikoje gjithashtu edhe nevojat per investime kapitale, me synim zhvillimin e sherbimeve te

veçanta dytesore.

F. Do te fuqizohen sistemet e informacionit shendetesor ne nivel lokal dhe qendror. Njekohesht, do te krijohen kushtet per koordinimin e rrjeteteve te ndryshme te informacionit. Ne kete kuader, nje rendesi te vecante marrin veprimet e meposhtme:

1. Konceptimi dhe ngritura e nje sistemi informacioni lidhur me sherbimet e nivelit shendetesor paresor, me qellim qe te behet me i matshem produktiviteti e te lehtesohen procedurat e financimit nga fondi i sigurimeve shendetesore.
2. Ndertimi i nje sistemi informacioni spitalor (his) qe do te beje te mundur monitorimin e performances se aktivitetit spitalor ne nivel kombtar. Ky sistem do ndihmoje ministrine e shendetesise ne vleresimin e sakte te situates dhe hartimin e politikave te drejta te sektorit spitalor si edhe do te pershpetoje futjen e skemes se sigurimeve shendetesore ne spitale.
3. Do te fuqizohen kapacitetet e mbledhjes dhe perpunimit te informacionit shendetesor ne nivel kombtar me qellim qe statistikat dhe treguesit e grumbulluar te botohen ne kohen e duhur dhe te jene te besueshme. Ne kete kuader do te mundesohet botimi i nje periodiku statistikor nga ministria e shendetesise.
4. Do te ndertohet nje mekanizem per koordinimin e te gjitha sistemeve te informacionit, te cilet i sherbejne sistemit shendetesor ne shqiperi. Ne kete drejtim, nje kontribut te rendesishem do te jape njesia e monitorim/vleresimit e ministrise se shendetesise.

## 1.2 Akreditimi

Akreditimi si sistem monitorimi e vleresimi periodik, synon ruajtjen e standardeve te larta ne dhenien e sherbimit shendetesor.

### 1.2.1 Akreditimi institucional

Akreditimi institucional kerkon qe ne nje periudhe 2-3 vjecare institucionet shendetesore (ambulancat, qendrat shendetesore, poliklinikat e spitalet e cdo kategorie) te vleresohen nese cilesia e sherbimit qe ato ofrojne eshte e kenaqshme, kushtet ambientale e te punes jane te pranueshme e te sigurta, pajisjet e aparaturat jane sipas standardit qe i takon, etj. Keto vleresime kerkojne sisteme te perparuara e te besueshme informacioni e realizohen nga grupe ekspertesh te njohur te fushave. Rezultatet e gjetura ballafaqohen me standardet ose ‘benchmark-et’ (standardet e perparuara) kombetare ose te huaja e beht vleresimi i pershkallezuar i institucionit me rekomandimet perkatese per ministrine e shendetesise. Meqenese nuk ka pervoje e tradite ne kete drejtim, shprehim vullnetin per ndertimin e nje procesi akreditimi gradual duke iu pershtatur kushteve te vendit tone per te cilin eshte e nevojshme edhe asistenza teknike e huaj.

### 1.2.2 Akreditimi individual

Akreditimi individual eshte monitorimi dhe vleresimi periodik i aftesive profesionale te individive (publike e private) qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne fushen e shendetesise. Ky proces eshte i lidhur ngushtesisht me proceset e edukimit te vazhdueshem dhe licensimit profesional dhe eshte perjegjesi e trefishte e ministrise se shendetesise, urdherave profesionale, (urdheri i mjekut, farmacistit), e shkollave universitare e pasuniversitare te mjekesise. Edhe per kete proces mungon tradita por egziston vullneti e jane vendosur lidhjet per nje asistente teknike te huaj.

### 1.2.3 Situata e problemet

Ne shqiperi nuk ka tradite per sistemet e akreditimit. Kohet e fundit eshte rritur interes i per vleren e rendesishme te ketij procesi por ende nuk ka veprime konkrete.

#### **1.2.4 Objektivi**

Do te krijojme nje sistem kombetar te akreditimit te sherbimeve shendetesore ne shqiperi.

#### **1.2.5 Strategjite**

Do te kerkohet asistence e huaj teknike me synimin qe te krijohen strukturat dhe mekanizmat e nevojshme per realizimin e ketij procesi i cili do te zbatohet ne menyre graduale ne spitale te vecanta, per t'u shtrire ne nje periudhe afat-mesme/afat-gjate ne te gjithe spitalet e vendit.

### **1.3 Organizatat partnere**

#### **1.3.1 Situata**

Urdherat dhe organizatat profesionale kane nje rendesi te vecante per rolin qe ato luajne ne:

- Mbrojtjen e profesionisteve e te publikut
- Ruajtjen e standardeve dhe pastertise se profesionit
- Vendosjen e rregullave per sjelljen e duhur profesionale te anetareve te tyre
- Vleresimin e kompetences per rregjistrimin dhe licensimin.

Nisur nga sa me siper, jane stimuluar e mbeshtetur krijimi i nje sere organizatash te tilla si urdheri i mjekut, urdheri i farmacistit, shoqatat profesionale te mjekeve, infermjereve, etj.

#### **1.3.2 Problemet**

- Pavaresisht se nga pikepamja strukturore jane bashkekohore jane ende larg rolit qe duhet te luajne edukimin, akreditimin, e licensimin e profesionisteve dhe ndeshkimin e abuzuesve dhe shkelesve te ligjit me bluze te bardhe.
- Jane ende larg krijimit te pavaresise financiare e cila eshte domosdoshmeri per te realizuar drejt e plotesisht funksionin e tyre.

#### **1.3.3 Objektivi**

Do te ndihmojme ne krijimin e konsolidimin e organizatave partnere, per t'i bere ato plotesisht te afta ne rolin e tyre.

#### **1.3.4 Strategjite**

- a. Ndhime metodike e financiare per organizatat qe funksionojne.
- b. Krijim i organizatave te reja aty ku mungojne.

### **1.4 Aktiviteti i sektorit privat**

### **1.4.1 Situata**

Ne sistemet ekonomiko-shoqerore qe bazohen ne ekonomine e tregut, egzistensa e tregut shendetesor privat krahas atij shteteror eshte domosdoshmeri per vlerat komplementare e konkurruese qe ai krijon. Nisur edhe nga mungesa e tradites, eshte nxitur, inkurajuar dhe mbeshtetur krijimi i tregut shendetesor privat ne shendetin paresor (klinika, laboratore, farmaci) e ne ate spitalor me ligjin e spitaleve. Por vihet re se ne praktike, shtrirja dhe zhvillimi i aktivitetit te sektorit privat ka ecur me hapa me te shpejta se ndertimi i kuadrit rregulator, duke sjelle per pasoje nje numer problemesh qe lidhen kryesisht me cilesine e sigurine e sherbimeve te ofruara.

### **1.4.2 Problemët**

- Mungon pervoja per monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit privat.
- Legjislacioni ne fuqi eshte jo i plete, me role ende te paqarta e masa penalizuese te jo efektive.
- Mungojne struktura te vecanta per monitorimin dhe kontrollin e cilesise se sherbimit e te aktivitetit te sektorit privat.
- Licensimi individual eshte diskriminues e ndonjehere kunderefektiv.
- Media vizive dhe e shkruar, jo rralle, luan nje rol negativ duke reklamuar edhe aktivitete te palicensuara.
- Koordinimi me ministrine e financave nuk eshte ne nivelin e duhur.

### **1.4.3 Objektivi**

Do te forcojme kapacitetet monitoruese dhe kontrolluese te aktivitetit privat ne shendetesi me synim mbrojtjen e shendetit te popullates nga abuzimet, e praktikat e demshme.

### **1.4.4 Strategjite**

- A. Do te permiresojme legjislacionin (ligje, vkm e urdhera) duke u mbeshtetur ne legjislacionin e be.
- B. Do te permiresojme standardet e detyruara per sherbimin mjekesor ne te gjitha aktivitetet private si klinika, laboratore, klinika stomatologjike, spitale.
- C. Do te ngreme struktura specifike (inspektoriat) per monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit privat me autoritetin e kompetencat e duhura.
- D. Do te koordinojme me mire me ministrine e financave (tatimet) per te ndeshkuar abuzuesit dhe shkelesit e ligjin.

## **1.5 Rol i pacientit**

### **1.5.1 Situata**

Sistemet shendetesore te perparuara kane ne qender te tyre pacientin. Megjithë perpjekjet e vazhdueshme per ta vendosur pacientin ne qender te sistemit shendetesor, jemi te vetedijshem se eggistojne probleme te ndryshme te cilat duhet te zgjidhen. Anketa dhe studime te kryera kohet e fundit kane treguar se pacientet shqiptare ne jo pak raste jane te pakenaqur nga niveli dhe cilesia e sherbimeve qe u ofron sistemi yne shendetesor. Kjo pakenaqesi spjegohet me:

- Cilesine e sherbimit qe ofrohet
- Mungesen e disa sherbimeve diagnostikuese e mjekuese
- Pagesat nen-dore per sherbimet diagnostike e kurative etj.

Keta faktore te kombinuar mund te shpjegojne se pse nje pjese e pacienteve shqiptare kerkojne sherbime diagnostikuese dhe mjekuese ne vende te ndryshme fqinje si turqia, italia apo greqia. Marrja e sherbimeve mjekesore ne vendet fqinje e shton barren e shpenzimeve mbi pacientet, te cilet duhet te paguajne teresisht

nga xhepi shpenzimet e ketyre sherbimeve, por gjithashtu edhe koston e udhetimit dhe te qendrimit ne keto vende.

Ne vendin tone nuk ka tradite dhe nuk jane perpunuar ende mekanizma efektive qe do te benin te mundur degjimin dhe marrjen parasysh te zerit te qytetareve ne proceset e formulimit te politikave shendetesore, te planeve kombetare apo te drejtimit te institucioneve shendetesore.

### **1.5.2 Problemët**

- Pakenaqesa e popullates per cilesine e sherbimit qe u ofrohet;
- Pagesat informale;
- Mungesa e mekanizmave te terheqjes se mendimit te popullates/pacientit per politikat/cilesine e sherbimit shendetesor.

### **1.5.3 Objektivi**

Do te forcojme rolin e pacientit ne vleresimin e nivelit te sherbimit shendetesor dhe hartimin e politikave shendetesore.

### **1.5.4 Strategjite**

- Do te ngreme zyren e pacientit, per mbrojtjen e te drejtave te pacientit ne te gjitha institucionet shendetesore e ne ministrine e shendetesise brenda vitit 2004.
- Do te permiresojme “karten e pacientit” dhe mekanizmat per zbatimin e saj te plete.
- Do te institucionalizojme perfaqesimin e pacienteve ne bordet e spitaleve.

# ORGANIZIMI DHE DECENTRALIZIMI

## 2

### 2.1.1 Situata

Decentralizimi si proces i delegimit te autoritetit nga niveli qendror ne nje nivel tjeter me te ulet, eshte i lidhur ngushte me kapacitetet menaxheriale te organeve rajonale e lokale.

Aktualisht, ka nje kontradikte ne procesin e decentralizimit ne fushen e shendetesise, pasi egziston prirja per te zbatuar paralelisht dy modele qe nuk perputhen krejtesisht me njeri tjetrit:

- Modeli i devoluimit te kompetencave dhe pronesise se institucioneve shendetesore drejt pushtetit te zgjedhur lokal. Nese ky koncept do te zbatohet plotesisht, do te sjelle si pasoje copetimin e piramides se sherbimeve shendetesore ne rreth 370 njesi administrative, aq sa eshte numri i per gjithshem i bashkive dhe komunave ne Shqiperi. Nje ndarje e tille rrezikon te sjelle nje perdonim jo-kosto efektiv te burimeve te pakta. Gjithashtu, ky model nuk perputhet me financimin e sherbimeve mjekesore nga sigurimet shendetesore.
- Modeli i autonomise se sherbimeve shendetesore. Ky model synon krijimin e sherbimeve shendetesore krejtesisht autonome, te kontraktuara dhe finançuara nga fondi i sigurimeve shendetesore. Me qellim qe keto sherbime te ruajne nje logjike teknike racionale dhe te ofrohen sipas nevojave te popullsive te zonave gjeografike te caktuara (psh. qarqet) eshte propozuar dhe ka filluar ne formen pilot ngritja dhe funksionimi i “autoriteteve shendetesore rajonale”, te cilat do te kene per gjegjesi per hartimin e planeve shendetesore rajonale si edhe menaxhimin e drejtperdrejt te programeve kombetare te shendetit publik. Ky model eshte mbeshtetur dhe po zbatohet si model pilot ne Tirane, ne kuadrin e nje projekti te finansuar nga Banka Boterore.

Pervoja e devoluimit te pjesshem te kompetencave mbi sherbimet e kujdesit paresor drejt pushtetit te zgjedhur lokal nuk ka patur efekte pozitive mbi sherbimet shendetesore paresore, pasi shperndarja e burimeve finanziare eshte realizuar ne menyre jo-efektive. Kjo mund te shpjegohet me paftesine e deritanishme te organeve te pushtetit vendor per te menaxhuar sic duhet sherbimet shendetesore, te cilat jane te nderlikuara sepse nderthurin aspekte teknike dhe administrative.

Ministria e Shendetesise eshte e mendimit se modeli me i pershtatshem do te ishte ai i autonomise se sherbimeve shendetesore, pasi parashikon financimin e ketyre sherbimeve nga fondi i sigurimeve shendetesore. Gjithashtu, ky model ruan integritetin e piramides se sherbimeve shendetesore, permes planeve shendetesore rajonale qe do te hartohen nga “autoritetet shendetesore rajonale” ne nivel qarku.

## 2.1.2 Problemët

Cili model do te zbatohet; devoluimi apo autonomia?

## 2.1.3 Objektivi

Do te ndertojme nje sistem shendetesor te bazuar ne modelin e nje bleresi te vetem me ofrues autonom por qe perfshin planifikim te dekoncetruar dhe funksione te shendetit publik ne nivel qarku.

## 2.1.4 Strategjite

1. Ministria e Shendetesise do te nxise krijimin e sherbimeve shendetesore autonome (Sherbimet e Kujdesit Shendetesor Paresor dhe spitalet autonome) sherbimi i te cilave do te financohet permes skemes se sigurimeve shendetesore dhe do te respektojne standardet e parashikuara nga Ministria e Shendetesise dhe autoritetet shendetesore rajonale. Brenda vitiit 2004 do te shqyrtohet baza ligjore dhe do te hartohet legjislacioni i ri qe do te mundesoje zbatimin ne praktike te reformes se propozuar.
2. Ministria e Shendetesise do te ndertoje autoritetet shendetesore rajonale, duke filluar nga viti 2004. Per kete qellim do te hartohen aktet e nevojshme ligjore mbi organizimin dhe decentralizimin e sistemit shendetesor, qe do te lejojne autonomizmin e sherbimeve shendetesore, si forma me e pershtatshme e decentralizimit ne shendetesi. Keto akte ligjore duhet te harmonizohen edhe me “Ligjin per Sherbimin Spitalor ne Republiken e Shqiperise”, i cili parashikon ngritjen e autoriteteve rajonale spitalore. Autoritetet shendetesore rajonale do te bejne te mundur zhvillimin e planifikuar dhe te koordinuar te sherbimeve shendetesore ne baze te njesive gjeografike qe do te mbulojne.
3. Veprimet konkrete per organizimin dhe decentralizimin e lartpermendor te sherbimeve shendetesore do te jene:
  - a. Do te formulohet, do te diskutohet dhe do te miratohet brenda vitiit 2004, «Liji baze i organizimit dhe funksionimit te sistemit shendetesor ne Shqiperi», si hap i rendesishem drejt autonomise se sherbimeve shendetesore si dhe krijimit te modeleve te decentralizimit brendainstitucional.
  - b. Do te fuqizohen kapacetetet e Autoritetit Shendetesor Rajonal te Tiranes lidhur me planifikimin e sherbimeve dhe menaxhimin e programeve rajonale te shendetit publik, si modeli i pare prej te cilit mund te nxirren mesime dhe perfundime te vlefshme mbi masat qe duhen marre apo veprimet qe duhen shmangur ne kete drejtim. Do te finalizohet plani i pare rajonal shendetesor i Tiranes (brenda vitiit 2004).
  - c. Do te shtrihet pervoja e funksionimit te autoriteteve rajonale edhe ne zona te tjera gjeografike. Hapi i pare ne kete drejtim do te jete ngritia e Autoritetit Shendetesor Rajonal ne Berat me ndihmen e projektit PHR-plus. Ministria e Shendetesise do te pergatise kushtet per shtrirjen e « autoriteteve shendetesore rajonale » ne te gjithe vendin. Ne kete kuader do te merren masa per integrimin e funksioneve te planifikimit, standardizimit, rregullimit etj. te sherbimeve paresore, atyre te shendetit publik si edhe sherbimeve spitalore brenda te njejtes strukture rajonale (autoritetit shendetesor).
  - d. Do te fuqizohen “bordet rajonale” vendimmarrese, te cilat do te perçojne interesat e te gjithe aktoreve te interesuar per zhvillimin e sistemit shendetesor te njesive perkatese gjeografike.

e. Do te ruhet perjegjesia per funksionet e shendetit publik ne nivel kombetar dhe rajonal. Ne kete menyre do te shmanget decentralizimi i perjegjesise per zbatimin e programeve shendetesore kombetare poshte nivelist te autoriteteteve shendetesore rajonale. Deri ne krimin e autoriteteteve rajonale, keto perjegjesi duhet te mbahen nga Ministria e Shendetesise dhe strukturat e saj periferike. Pushteti i zgjedhur vendor do t'i bente nje sherbim te paçmuar shendetit publik te komuniteteve, nese do te ngarkohej me perjegjesine e zgjidhjes se problemeve social shendetesore si kufizimit dhe kontrollit te agresionit te reklamave te duhanit apo produkteve alkolike, prej te cileve preken me teper adoleshentet dhe te rintje; problemi te furnizimit me uje te pijshem higjenikisht te paster; problemi te largimit dhe trajtimit te mbeturinave te ngurta; problemi madhor te evakuimit dhe perpunimit te ujrate te zeza e te bardha; problemi te krijimit dhe ruajtjes se mjediseve te shendetshme urbane, me nivel te ulet ndotje te ajrit, me trafik te disiplinuar dhe te qete, me hapesira te gjelbera si edhe me nivel te ulet te zhurmave etj.

# BURIMET NJEREZORE<sup>3</sup>

## 3.1.1 Situata

Sistemi yne shendetesor ka nje numer te kufizuar burimesh njerezore. Raporti i mjekeve shqiptare me popullsine eshte afersisht 1,36 per 1000 banore, ç'ka e rendit vendin tone nder nivelet me te ulta te rajonit europian. Ndersa raporti i personelit te mesem mjekesor eshte afersisht 3.7 per 1000 banore, shifer e krahasueshme edhe me disa vende te Bashkimit European si Spanja dhe Portugalia.

Nje nga problemet e mprehta me te cilat po perballat aktualisht Ministria e Shendetesise eshte shperndarja jo e njetrajtshme e personelit mjekesor, gje qe sjell pamundesi per te mbuluar shume komunitete me sherbit mjekesor. Kjo vjen si pasoje e braktisjes nga ana e mjekeve te zonave te veshtira rurale si edhe per shkak te levizjeve te brendeshme migratore te popullsise, qe e bejne te veshtire planifikimin e nevojave per sherbime mjekesore.

Ministria e Shendetesise ende nuk zoteron nje plan kombatar te plote te burimeve njerezore ne sektorin e shendetesise i cili te beje parashikime afatmesme e afatgjata mbi levizjet e largimet e mjekeve te per gjithshem apo specialistet e kategorive te ndryshme, daljet ne pension etj. qe jane te domosdoshme me qellim qe te ruhet ekuilibri midis "prodhimit" te burimeve te reja njerezore me keto levizje.

Sektori i shendetesise ne Shqiperi po perballat me humbjen e vazhdueshme te elites se tij profesionale per disa aresye:

1. largimit te specialisteve jashte vendit;
2. daljes graduale ne pension te specialisteve me ne ze te sherbimeve te specializuara universitare;
3. mos-terheqjes se klinicisteve te rinj
4. mungeses se specializimeve universitare afat-gjata ne vende me sistem mjekesor te zhvilluar.

Kjo mund te sjelle pasoja afatgjata lidhur me ofrimin e sherbimeve te specializuara ne nivelin dytesor dhe tretesor, duke patur vecanerisht impakt ne nivelin e mesimdheneies dhe te formimit te mjekeve te rinj nga Fakulteti i Mjekesise.

Shqiperia ka një numer te pamjaftueshem mjekesh te familjes (rreth 0,5 mjeke per 1000 banore). Specialiteti i mjekut te familjes eshte futur vetem vitet e fundit dhe vazhdon te mbetet specialiteti me pak i deshiruar dhe me i diskriminuar i mjekesise. Gjithashu, tek popullsia shqiptare mbisundon mentaliteti i nenvleftesimit te mjekeve te per gjithshem, duke i dhene perparesti mjekeve specialiste dhe sherbimeve te specializuara. Eshte teper e rendesishme krijimi dhe fuqizimi i mjekeve te familjes, nepermjet rritjes se aftesive te tyre teknike dhe permiresimit te infrastrukturese se kujdesit paresor. Ne kete drejtim, eshte perpareshore edhe ndryshimi i perceptimeve dhe qendrimeve te popullsise ndaj sherbimeve te ofruara nga mjeket e per gjithshem apo mjeket e familjes.

Sektori i burimeve njerezore ka trasheguar mangesi tradicionale ekspertesh ne fusha te caktuara si shendetet publik, menaxhimi shendetesore, ekonomia shendetesore, promocioni shendetesore, politikat dhe planifikimi i shendetesise etj. Kjo po sjell pengesa serioze vecanerisht ne menaxhimin e institucioneve shendetesore sipas koncepteve bashkekohore. Rjedhimisht edhe vete menaxhimi i burimeve njerezore ne te gjitha nivelet e sistemit shendetesor po has ne pengesa dhe veshtiresi, te cilat shfaqen permes mungeses se planeve te karrieres, mungeses se stimujeve, paaftesise per te krijuar mqedise pune qe terheqin me te aftet dhe nxisin produktivitetin e kuadrove, mungeses se trajnimeve te vazhduara dhe periodike etj.

Probleme te mprehta egzistojne edhe ne fushen e infermieristikes, ku formimi profesional baze vazhdon te kete luhatje dhe te jete i pastandardizuar. Kjo kategori profesionale eshte teper heterogjene per nga niveli i shkollimit dhe pervojes. Duhet permendur se edhe personeli i mesem mjekesor (infermjere/mami) po braktis vendin, si pasoje e krizes se ketij profesiuni ne vendet e Europees Perendimore dhe i terhequr nga njojja e diplomave dhe ofertat e punes nga keto vende (vecanerisht Italia). Rrjedhimisht, Shqiperia investon per formimin dhe diplomimin e infermjereve dhe mameve, te cilat gjejne vende pune ne perendim.

Sektori i shendetesise ende nuk ka ngritur një sistem te kreditimit per te gjitha kategorite profesionale, ç'ka do te bente te mundur ruajtjen e standardeve profesionale si edhe do te lejonte futjen e kritereve te percaktuara qarte lidhur me licensimin e profesioneve mjekesore.

Institucionalizimi i nje sistemi te edukimit ne vazhdimesi eshte domosdoshmeri per freskimin dhe perditesimin (update) e njojuri profesionale. Praktikisht, ky proces eshte i lidhur ngushte me kreditimin dhe licensimin e detyrueshem profesional e ndikon fuqishem ne permiresimin e cilesise se sherbimit.

### 3.1.2 Problemet

- Numri i kufizuar i burimeve njerezore shendetesore,
- Shperndarja jo e barabarte e personelit mjekesor,
- Mungesa nje plani kombetar te burimeve njerezore,
- Pakesimi i elites profesionale,
- Numer i pamjaftueshem mjekesh te per gjithshem e te familjes,
- Mangesi tradicionale ekspertesh ne fusha te caktuara si shendetet publik, menaxhimi shendetesore, ekonomia shendetesore, promocioni shendetesore, politikat dhe planifikimi i shendetesise etj.,
- Formimi profesional baze ne fushen e infermieristikes vazhdon te kete luhatje dhe te jete i pastandardizuar,
- Mungesa e sistemit te kreditimit profesional,
- Mungesa e nje sistemi te edukimit te vazhdueshem profesional

### 3.1.3 Objektivi

Do te krijojme nje sistem kombetar te burimeve njerezore shendetesore te pote e te afte per te realizuar me sukses funksionet e tyre ne ruajtjen dhe permiresimin e shendetit te popullates.

### **3.1.4 Strategjite**

- a. Brenda vitit 2005 do te hartohet nje plan kombetar te zhvillimit te burimeve njerezore ne sektorin e shendetesise, i cili do te parashikoje veprimet per zgjidhjen e pjeses me te madhe te ceshtjeve dhe problemeve te lartpermendura. Komponente te rendesishme te ketij plani do te jene;
  1. zevendesimi dhe formimi i specialisteve te sherbimeve dyesore dhe tretesore
  2. zhvillimi i specialiteteve te mangeta
  3. si edhe zhvillimi i profesioneve paramjekesore si infermieret, mamite e profesione te tjera.
- b. Do te permiresohet shperndarja gjeografike e personelit mjekesor nepermjet aplikimit te parimeve te tregut te punes:
  1. Financim publik – sherbim privat
  2. Shperblim i diferencuar ne vartesi te kerkese – ofertes
  3. Stimulim me bursa me kontrata me kushte detyruese ligjore per mbulimin e zonave te veshtira rurale.
- c. Do te permiresohen ndjeshem kontratat e punes me personelin duke i bere me pershkruese, me te perqejgjshme e dinamike.
- d. Do te zbatohen politika efektive te zgjedhjes se drejtuesve rajonale te shendetesise nepermjet konkurimit profesional.
- e. Do te perqatitet nje dokument politiko - strategjik mbi sherbimin infermieristik ne Shqiperi, i cili do te percaktoje standartet e organizimit e funksionimit te ketij sherbimi.
- f. Do te ngrihet nje Qender e Formimit te Vazduar Profesional e cila do te kete nje fond e do te jetet perqejgjese per koordinimin dhe organizimin e aktiviteve te trajnimit te vazduar per mjeket dhe infermjeret e Shqiperise. Trajnimet do te jepen nepermjet mobilizimit te trajnereve/pedagogeve me te mire shqiptare ose te huaj, ne varesi te perpareseve dhe nevojave te vendit.
- g. Brenda vitit 2005 do te ngrihet Shkolla e Shendetit Publik dhe te Menaxhimit Shendetosor, si strukture e Fakultetit te Mjekesise te Universitetit te Tiranës. Do te krijohen kushtet ligjore dhe institucionale per ngritjen dhe funksionimin e sistemit te trajnimeve ne fushat e rendesishme te shendetit publik, menaxhimit shendetosor dhe nen-degeve te tyre. Shkolla e Shendetit Publik do te jetet produkt i te gjitha burimeve njerezore egzistuese ne Shqiperi (Fak. i Mjekesise, Instituti i Shendetit Publik dhe specialiste te pavarur). Krijimi i kuadrit te nevojshem ligjor dhe institucional do te beje te mundur qe edhe iniciativat e asistences se donatoreve te huaj ne kete drejtim te jene me eficiente dhe me te koordinuara.
- h. Do te fuqizohet institucioni i mjekut te familjes permes:
  1. Rritjes se cilesise se formimit pas-universitar ne Fakultetin e Mjekesise. Mbeshtetja e universiteteve te huaja me tradite ne kete fushe do te konsiderohet si nje perparese e rendesishme;
  2. Ngritjes dhe institucionalizimit brenda vitit 2006 te nje kursi formimi te vazduar profesional ne mjekesine e familjes, me qellim qe te permiresohen ne menyre thelbesore njojurite, shprehite dhe praktika klinike e mjekeve te perqjithshem. Ky kurs do te institucionalizohet, me qellim qe te trajnohen te gjithe mjeket e perqjithshem qe praktikojne mjekesine e familjes. Meqenese ky projekt eshte ambicioz dhe afatgjate, do te jetet e nevojshme qe kursi i trajnimit te ngrihet dhe te fuqizohet se pari ne Tirane e ne nje faze te dyte te decentralizohet dhe te ofrohet edhe ne zona te tjera gjeografike te vendit, me qellim qe te realizohet nje formim tip kaskade.
  3. Ndryshimit te imazhit te mjekut te familjes. Ky proces duhet te kaloje nepermjet permiresimit te praktikes klinike te kesaj kategorie profesionale si edhe permes nje filozofie te re te trajtimit te problemeve te individit dhe komunitetit. Permiresimi i praktikes se mjekesise se familjes do te beje te mundur zgjidhjen e nje pjese te mire te problemeve mjekesore ne kete nivel sherbimi, duke cliruar sherbimet e

specializuara nga barra e panevojshme e pacienteve. Nje rendesi te vecante ne kete drejtim do te kene edhe fushatat promovuese qe do te synojne sqarimin e rolit te rendesishem te mjekeve te familjes.

1. Do te ndertohet nje sistem i kreditimit te profesionisteve te kategorive te ndryshme te shendetesise. Ndertimi i ketij sistemi eshte i lidhur ngushte dhe mund te realizohet vetem ne prani te programeve te trajnimit te vazhduar qe duhet t'u ofrohen te gjithe profesionisteve te sektorit shendetesor kundrejt nje pagese te aresyeshme. Per kete eshte e nevojshme pervaaja e asistenza tekniqe e huaj.

# FINANCIMI

4

## 4.1.1 Situata

Financimi eshte nje nga sfidat me te veshtira qe po perballon sistemi yne shendetesor sot. Shpenzimet publike te shendetesise kane marre rrith 2.7% te PBB-se gjate vitit 2003. Kjo shifer supozohet se arrin deri ne rrith 4% ose 5% te PBB-se, nese ketu do te perfshiheshin edhe pagesat e drejtperdrejta te konsumatoreve per sherbime shendetesore private apo pagesat nen-dore. Shpenzimet e sektorit te shendetesise ne Shqiperi kane qene te ulta ne krahasim me vendet e tjera europiane apo edhe me nje pjese te vendeve ish-socialiste te Europees Qendrore dhe Lindore. Trajtimi i sektorit te shendetesise si prioritar ne Strategjine Kombetare te Zhvillimit Ekonomik e Social (SKZHES), parashikon shpenzimin e 3.2% te PBB per kete sektor ne vitin 2006.

Shqiperia e ka percaktuar skemen kombetare te sigurimit si financuesen e sherbimeve shendetesore te te gjitha llojeve e bindur nga perparesite qe ka kjo e fundit. Aktualisht, skema e sigurimeve mbulon vetem pagat e mjekeve te familjes si edhe nje pjese te kostos se barnave te perfshira ne listen e barnave esenciale. Ministria e Shendetesise dhe Instituti i Sigurimit te Kujdesit Shendetesor kane bere perpjekje per avancimin e metejshem te kesaj skeme nepermjet financimit te sherbimeve shendetesore shtese, duke perfshire ne kete mbulim edhe financimin e kujdesit shendetesor paresor ne rajonin e Tiranes si edhe financimin e spitalit rajonal te Durresit. Megjithate, ritmet e shtrirjes se skemes se sigurimeve shendetesore per mbulimin dhe financimin e sherbimeve te tjera mjekesore kane qene te ngadalshme.

Skema e sigurimeve shendetesore ne Shqiperi eshte ndeshur me nje sere veshtiresish dhe problemesh, te cilat kane ndikuar ne procesin e shtrirjes dhe funksionimit te saj. Keshtu, kontributet nga te vetepunesuarit dhe sektori privat jane grumbulluar ne nje mase te vogel dhe te pamjaftueshme, si pasoje e mungeses se informacionit dhe te ndergjegjesimit te ketyre kategorive te popullsise per perfitimet qe vijne nga sigurimet shendetesore. Efekt negativ ne grumbullimin e paket te kontributeve ka patur edhe vjelja e tyre nga rrjeti i nje institucion i tjeter, qe eshte ai i sigurimeve shoqerore. Instituti i Sigurimit te Kujdesit

Shendetesor e konsideron perqindjen e kontributeve mbi te ardhurat si te paket dhe te pamjaftueshme per te sjelle ndryshime te rendesishme ne financimin e sherbimeve mjekesore. Per kete aresye eshte hedhur mendimi i shtimit te mases se kontributeve individuale (shtimi i kontributit si perqindje mbi te ardhurat), gje qe pritet te rrise fondin ne dispozicion te sigurimeve shendetesore.

Megjithe perpjekjet e bera si edhe asistencen teknike qe ka marre, Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor ka ende kapacite te kufizuara lidhur me perpunimin dhe zbatimin e mekanizmave te financimit te sherbimeve mjekesore, vecanerisht te sherbimeve te specializuara spitalore. Keshtu, edhe ne financimin e spitalit te Durrësit, skema e sigurimeve nuk ka aplikuar ndonje mekanizem te qarte kontraktimi dhe financimi, por eshte bere nje transferuese e thjeshte e buxhetit te spitalit, te alokuar nga Ministria e Financave.

Financimi i shendetesise ne Shqiperi karakterizohet nga pamjaftueshmeria e fondeve publike per te mbuluar ne menyre te kenaqshme sherbimet shendetesore. Nga ana tjeter, patientet shqiptare paguajne shuma te rendesishme ne klinikat private jashte vendit, vecanerisht per sigurimin e sherbimeve te specializuara diagnostiko-kurative, sidomos te atyre qe kerkojne teknologji te avancuara. Gjithashtu, patientet paguajne ne menyre informale per nje pjese te sherbimeve qe u ofrohen ne spitalet dhe klinikat publike. Natyrisht, te gjitha keto shuma shkojne ne xhepat e mjekeve dhe te personelit tjeter shendetesor, nderkohe qe pagesat e ligjshme jane pothuajse te pakonsiderueshme. Neqoftese keto pagesa do te vilesin nga sherbimet shendetesore publike dhe do te perdoreshin me efektivitet, do te ndikonin ne permiresimin e cilesise se ketyre sherbimeve.

Ministria e Shendetesise po ben perpjekje perte bere nje planifikim sa me racionale zhvillimit te sherbimeve shendetesore ne nivel kombetar, perfshire ketu edhe nje proces alokimi sa me te aresyeshem te buxhetit te shendetesise. Por ne kete drejtim po hasen veshtiresi per aresye te kapaceteteve te pamjaftueshme teknike dhe pengesave strukturore, qe e mbajne te ndare funksionin e planifikimit te sherbimeve nga funksioni i planifikimit te buxhetit. Aktualisht, alokim i fondeve realizohet mbi baza historike, mbeshtetur kryesisht ne shpenzimet dhe kapacetetet e institucioneve dhe jo mbi nevojat dhe perparese reale te popullsive, sidomos te atyre me te varfera dhe me te privuara nga sherbimet. Ende nuk egziston asnje mekanizem i percaktuar dhe standart per alokin e buxhetit te shendetesise nga qendra drejt periferise. Nje ndihme te konsiderueshme ne kete drejtim do t'i jepnin ministrise autoritetet shendetesore rajonale nepermjet hartimit te planeve dhe buxheteve rajonale.

#### **4.1.2 Problemët**

- Pamjaftueshmeri e financimit ne shendetesi,
- Skema kombetare e sigurimeve shendetesore eshte ende e pakonsoliduar dhe e kufizuar,
- Planifikimi e buxhetimi jo te bashkerenduara,
- Menaxhim jo eficient i burimeve financiare.

#### **4.1.3 Objektivi**

Te zgjerojme bazen e burimeve financiare, masen e financimit dhe kosto-efiktivitetin e perdonimit te tyre.

#### **4.1.4 Strategjite**

1. Do te permiresohet legjislacioni per financimin e sistemit shendetesor me hartimin e "Ligjit te Financimit te Shendetesise" (Qershori 2004) dhe permiresimin e ligjit mbi Sigurimet Shendetesore, brenda vitit 2004 qe do te bejne te mundur menjimin e pengesave dhe veshtiresive ne zbatimin e shtrirjes se sigurimeve shendetesore per te mbuluar sherbimet spitalore. Kjo po realizohet permes nje pakete asistence teknike, ne mbeshtetje te grupeve te eksperteve teknike dhe ligjore te Ministrise se Shendetesise, Ministrise se Financave dhe te Institutit te Sigurimit te Kujdesit Shendetesor.
2. Do te shtohen fondet publike ne dispozicion te sektorit te shendetesise. Kjo do te beje te mundur nje financim me te mire te sherbimeve shendetesore dhe rrjedhimisht nje permiresim te cilesise se

sherbimeve si edhe te treguesve shendetesore te popullsise. Ne te njejten kohe, do te mbrohen fondet e alokuara per shendetesine duke nderthurur zgjerimin dhe permiresimin e mekanizmave te decentralizimit (autonomia e sherbimeve mjekesore dhe ngritja e Autoriteteteve Shendetesore Rajonale) me financimin e sherbimeve nga skema e sigurimeve shendetesore.

3. Do te zgjerohet skema e sigurimeve shendetesore duke u shtrire drejt:
  - a. financimit te sherbimeve te praktikes klinike te mjekeve te familjes, permes kontraktimit te drejtperdrejte te ketyre sherbimeve me grupe te praktikes autonome apo mjekeve te familjes qe ushtrojne profesionin ne menyre individuale;
  - b. financimit te mjekeve specialiste qe ofrojne sherbime te specializuara ambulatore ne poliklinika dhe spitale publike apo ne qendra private;
  - c. financimit te metejshem te sherbimeve te specializuara spitalore nga kjo skeme. Ne kete kuader do te permiresohen dhe konsolidohen mekanizmat kontraktuese dhe financuese ne projektin pilot te spitalit te Durresit. Njekohesht, do te filloje kontraktimi edhe i spitaleve te tjera duke sjelle nje zgjerim gradual te skemes drejt spitaleve te niveleve te ndryshme dhe ne zona gjeografike me karakteristika te ndryshme.
4. Do te filloje kontraktimi i drejtperdrejte i ofruesve te sherbimit te kujdesit shendetesor paresor qe punojne ne grupe ose individeve (mjeke te per gjithshem/familjes). Kontraktimi do te behet ne baze te paketave te sherbimeve. Paketat e sherbimeve duhet te percaktohen nga Ministria e Shendetesise ne perputhje me nevojat dhe planifikimin e sherbimeve ne nivel qarku. Projekti pilot i Tiranës dhe modeli qe po aplikohet ne Berat do te zhvillohet me tej.
5. Do te perpunohen mekanizma financimi te sherbimeve shendetesore paresore (nga grupi apo mjeku individual i familjes), me qellim qe te shtohet produktiviteti dhe cilesia e sherbimeve dhe te permiresohen treguesit shendetesore. Fondi i sigurimeve duhet te mbuloje teresisht koston e paketes se sherbimeve, c'ka perfshin pagen e mjekeve, pagen e personelit jo-mjekesor si edhe koston e shpenzimeve operative. Do te percaktohet qarte modeli i pageses se mjekeve te familjes. Nje zgjidhje e pershtatshme mund te ishte adoptimi i nje modeli te kombinuar te pageses per fryme (per capita) me pagesen per sherbim (fee-for-service), ne menyre qe te shmangen efektet negative te nje forme pagese te vetme. Per percaktimin e sakte te mekanizmave te kontraktimit dhe pageses me sherbimet mjekesore autonome te kujdesit paresor eshte e nevojshme asistence e huaj teknike nga vende qe kane pervoje te gjate me mekanizma te tille financimi dhe modele te ngjashme te praktikes se familjes.
6. Do te perpunohen mekanizma racionale te kontraktimit te sherbimeve spitalore ne spitalin e Durresit, me qellim qe ky model te sherbeje edhe ne spitale te tjera te vendit. Kjo do te menjanoste improvizimet dhe mungesen e profesionalizmit ne kete drejtim. Do te perfshihet edhe nje ose me shume spitale rrathi ne skeme, duke aplikuar modelet e reja te menaxhimit dhe te financimit. Edhe per kete nderhyrje teper te rendesishme dhe te veshtire eshte e nevojshme asistence e huaj me qellim qe te perpunohen me sakte mekanizmat kontraktues dhe financues te sherbimeve spitalore nga sigurimet shendetesore.
7. Do te ndertohen mekanizma te matjes se kosto-efektivitetit te sherbimeve shendetesore, vecanerisht atyre dytesore dhe tretesore te cilat jane me te kushtueshme (sisteme te menaxhimit te informacionit). Kjo do te krijoje kushtet per permiresimin e alokimit dhe shperndarjes se fondeve drejt sherbimeve me kosto-efektive dhe me cilesi me te larte. Njekohesht, keto informacione do te ndihmojne dukshem ne alokimin e fondeve spitalore bazuar ne performancen e seicilit spital si edhe per te krahasuar spitalet e ndryshme. Nje rol te rendesishem ne kete drejtim do te luajne autoritetet shendetesore rajonale te cilat do te grumbullojne dhe perpunojne informacione te nevojshme per krijimin e kushteve te transparencës ne drejtim te aktivitetit te sektorit spitalor ne Shqiperi. Keshtu, nje nga mekanizmat do te jete edhe matja e performances spitalore permes krijimit te nje serie treguesish te produktivitetit, cilesise se sherbimeve, rezultateve te nderhyrjeve, kenaqjes se pacienteve etj. OBSH-ja po jep asistence ne kete drejtim.

8. Do te studiohet dhe aplikohet bashkepagesa ne disa sherbime diagnostike dhe kurative si nje mase shume e rendesishme mbi te gjitha per te shmangur abuzimet e burimeve ne shendetesi.
9. Do te fuqizohen kapacitetet per zhvillimin e nje sistemi te Llogarise Kombetare te Shendetesise. Per kete qellim Ministria e Shendetesise do te bashkepunoje ngushte me Ministrine e Financave si edhe me konsulente te huaj qe kane pervoje ne kete drejtim.

10. Financimi i Shendeti Publik do te jetë perjegjesi e shtetit.

# MENAXHIMI

# 5

## 5.1.1 Situata

Sistemi yne shendetesor zoteron kapacitete te pakta ne fushen e menaxhimit shendetesor. Egziston nje numer teper i kufizuar specialistesh te formuar (jashte vendit) ne teknikat e menaxhimit te sherbimeve shendetesore dhe nje pjese e tyre punojne jashte sektorit publik te terhequr nga pagat e larta.

Strukturat organizative te institucioneve shendetesore jane te njeanshme me komponentin klinik te zhvilluar mire e komponentin menaxherial te atrofizuar ku menaxhereve nuk u eshte lene hapesira e nevojshme per te realizuar funksionin e tyre.

Ne drejtimin dhe menaxhimin e institucioneve shendetesore, trashegojme nje prirje te theksuar centralizuese. “Njeshi” i institucionit vendos per gjithshka; pranimin e largimin nga puna te stafit te te gjitha niveleve, menaxhimin e buxhetit e deri te elementeve me periferike e te parentesishme. Drejtuesit e niveleve me te ulta jane formale e pa asnje kopetence. Kjo i ben keta te fundit te jene indiferente e te painteresuar per rezultatet e punes pasi nuk ndjehen pjesetare te suksesit a pergjegjes te deshtimit. Edhe perpjekjet e ketyre viteve per krijimin e bordeve a keshillave drejtuese kane rezultuar jo efektive pasi per gjithesisht keto borde jane formale e nuk e kryejne funksionin per te cilin jane krijuar.

Tradisionalisht, ne rolin e menaxhereve te institucioneve tona shendetesore jane angazhuar kliniciste te shquar (kirurge, kardiologe etj.) te cileve, shpesh, u kane munguar edhe konceptet baze te menaxhimit. Po keshtu, ne parim kjo zgjidhje ka konflikt interesit pasi nje klinicist eshte i interesuar me shume per ecurine e te semurit e me pak per menaxhimin e rrepte. Nga ana tjeter, angazhimi i tij eshte gjithmone i manget (part-time) pasi puna ne klinike i merr kohe te konsiderueshme. Ministria e Shendetesise po percatit nje reforme te thelle ne kete drejtim per zevendesimin e te gjithe drejtuesve te institucioneve shendetesore me menaxhere te trainuar.

Sektori i shendetesise ende nuk ka perpunuar modele bashkekohore te drejtimit dhe menaxhimit te

spitaleve, poliklinikave si edhe te sherbimeve te kujdesit shendetesor paresor. Nuk egzistojne standarte te menaxhimit modern mbi te cilat te mbeshtetet praktika e menaxhimit te sherbimeve shendetesore, vecanerisht sherbimeve spitalore, te cilat jane komplekse dhe te kushtueshme.

Sistemet e informacionit klinik e finanziar jane pak te zhvilluara dhe kjo veshtireson futjen e praktikave te perparuara te menaxhimit modern. Edhe ai informacion qe mblidhet nuk shfrytezohet sa e si duhet per miremenaxhimin e institucioneve. Jane te paket specialistet e fushes se menaxhimit te informacionit shendetesor. Bashkepunimi i nisur me Agjensine Suedze te Zhvillimit Nderkombetar (SIDA) eshte shume premtues ne kete drejtim.

Mungon institucionalizimi i "prodhimit" te menaxhereve ne vend. Nuk egziston ende nje shkolle menaxhimi shendetesor apo shendetit publik. Departamenti i Shendetit Publik i Fakultetit te Mjekesise u ofron elemente baze te menaxhimit shendetesor studenteve te ciklit te ulet universitar, por akoma nuk eshte ngritur nje program post-universitar per formimin e kuadrove ne kete fusha. Megjithe perpjekjet e bera, sidomos keto vitet e fundit, kapacitetet mesimdheneze dhe pedagogjike te ketij departamenti jane te kufizuara. Nga ana tjeter, egzistojne veshtiresi serioze institucionale ne drejtim te trajnimit ne menaxhim shendetesor. Ministria e Shendetese eshte institucion me i interesuar per te patur sa me teper njerez te formuar, me qellim qe te rrise dhe te permiresoje kapacitetet menaxheriale te sherbimeve shendetesore spitalore apo paresore. Por ne baze te legjisacionit shqiptar, vetem Ministria e Aresimit dhe e Skences dhe universitetet kane te drejte te organizojne formime pas-universitare apo trajnime afat-gjata ne fusha te ndryshme, perfshire edhe fushen e menaxhimit shendetesor. Mungesa e nje institucion apo shkolle te mirefillte formimi ne fushen e menaxhimit shendetesor e veshtireson se tepermi ngritjen dhe vijueshmerine e programeve trajnuese ne fushen e drejtimit dhe te menaxhimit shendetesor.

Krahas rritjes se kapaciteve per formimin afatgjate post-universitar ne menaxhim shendetesor, nje nga perpareste e sektorit shendetesor eshte edhe ndertimi i kurseve afatshkurtera formuese ne parimet dhe praktikat e menaxhimit modern te organizatave dhe sherbimeve shendetesore. Organizimi i ketyre kurseve, megjithese te paket ne numer, ka sjelle nje impakt pozitiv ne njojen me parimet baze te menaxhimit me drejtues te shendetesise. Keto kurse duhet te ofrohen ne menyre te vazhduar me qellim qe te mbulohen sa me teper nevojat e vendit. Qendra e edukimit te vazhdueshem te burimeve njerezore duhet te jape nje kontribut te rendesishem ne kete drejtim.

Krijimi i sherbimeve shendetesore autonome do ta shtonte se tepermi nevojen per te patur sa me teper menaxhere profesioniste apo personel me trajnimin e domosdoshem per realizimin sa me profesional te funksioneve administrative dhe menaxheriale pasi autonomia ne thelb ka rritjen e kontrollit mbi fondet e burimet njerezore.

### 5.1.2 Problemët

- Shqiperia zoteron kapacite te dobeta e te pakta ne fushen e menaxhimit shendetesor,
- Struktura organizative deficiente e te njeanshme te institucioneve shendetesore,
- Decentralizim i manget brendainstitucional,
- Angazhim i klinicisteve ( pa trainimin e duhur menaxherial) ne rolin e menaxhereve te institucioneve,
- Mungojne modele te menaxhimit modern te institucioneve shendetesore,
- Sistemet e informacionit klinik e finanziar jane pak te zhvilluara,
- Mungesa e institucionalizimit "te prodhimit" te menaxhereve ne vend,
- Mungesa e kurseve afatshkurtera te menaxhimit,

### 5.1.3 Objektivi

Do te fuqizohen kapacitetet menaxheriale ne te gjitha nivelet e sistemit shendetesor, me qellim qe te zevendesohen praktikat e vjeteruara me praktika, standarde dhe modele sa me profesionale dhe bashkekohore.

## **5.1.4 Strategjite**

- a. Do te krijohet profesioni i menaxherit te shendetesise nepermjet ketyre rrugeve :
1. Stimulimit dhe thithjes se profesionisteve te formuar jashte vendit ne pozicione drejtuese e qe aktualisht punojne jashte sistemit shendetesor shteteror
  2. Shtimit te numurit te kuadrove te formuar jashte me kontrata detyruese per tu kthyer e sherbyer ne vend.
  3. Pergatitjes se menaxhereve nga Shkolla e Shendetit Publik dhe e Menaxhimit Shendetesor, qe do te krijohet ne vend.
- b. Do te forcohen kapacitetet menaxheriale te mjekeve te kujdesit shendetesor paresor. Profesionistet e kujdesit paresor duhet te mesojne nocionet baze te menaxhimit te njerezve, financave dhe te sherbimeve. Per kete qellim do te ndertohen dhe do te institucionalizohen kurse trajnimi me teknikat e mikro-menaxhimit te sherbimeve te kujdesit paresor, per t'iu pergjigjur nevojave konkrete te ketyre sherbimeve ne Shqiperi. Kurset e trajnimit do te vihen ne jete, se pari ne rajonin e Tiranes, ku projekti i Bankes Boterore po jep ndihme ne kete drejtim. Me pas, do te institucionalizohet me qellim qe te ofrohet ne vazhdimesi ne te gjithe territorin e vendit.
- c. Do te forcohen kapacitetet menaxheriale te drejtuesve te shendetesise ne nivele te ndryshme si psh. Autoritetet shendetesore rajonale, drejtuesit ne nivel rrethi apo qarku, institucionet shendetesore kombetare etj.
- d. Do te forcohen kapacitetet menaxhuese spitalore permes ketyre masave:
- i. Perpunimit te nje modeli te ri te « spitalit autonom » brenda vitit 2005. Ky model do te perpunohet dhe do te zbatohet fillimisht ne spitalin rajonal te Durrësit, duke çuar me tej inisitiven e filluar. Do te perpunohen edhe mekanizmat e autonomise spitalore per t'u zbatuar ne Qendren Spitalore Universitare te Tiranes.
  2. Perpunimit te nje «modeli te ri te menaxhimit spitalor », te pershtatur per kushtet e spitaleve te Shqiperise. Ky model do te perfshije:
    - Strukture organizative te ekuilibruar me 2 pole, mjekesor dhe menaxherial. Drejtori mjekesor me stafin e tij do te zgjidhe problemet teknike ndersa Menaxheri me stafin e tij do te menaxhoje burimet financiare.
    - Decentralizim funksional brendaspitalor, ku cdo sherbim te kete autonomi ne menaxhimin e te gjitha burimeve (edhe financiare).
    - Ngritje te sistemeve bashkekohore te informacionit klinik e finanziar si kerkesa te domosdoshme per nje menaxhim efektiv.
    - Vendimmarrje kolektive duke i bere funksionale e te pergjegjshem borde drejtuese te spitaleve.
  - e. Do te ngrihet Shkolla e Shendetit Publik dhe e Menaxhimit Shendetesor, e cila do te bejne te mundur edukimin ne vazhdimesi te kuadrove te reja ne fushat e menaxhimit te sherbimeve shendetesore.

# SHERBIMET SHENDETESORE

6

## 6.1 SHENDETIT PUBLIK

### 6.1.1 Situata

Sherbimi i Shendetit Publik eshte sherbimi shendetesor me i konsoliduar ne vend. Harmonizimi i drejte i nderhyrjeve vertikale me programe kombetare si ai i imunizimit, i shendetit riprodhues, surveillances epidemiologjike etj. me rrjetin higjeno – sanitari e epidemiologjik lokal ka sjelle rezultate te kenaqshme ne mbrojtjen e shendetit te popullates. Ketu ka ndikuar jo vetem ruajtja e sistemit te trasheguar por edhe asistenza e fuqishme teknike e OBSH dhe shume organizmave e institucioneve respektive te shteteve te zhvilluara sidomos gjate e pas ngjarjeve te Kosoves te viti 1999. Praktikisht vleresohet qe Shqiperia te kete nje nga sistemet e surveillances epidemiologjike me te mire ne Ballkan. Situata e shendetit publik ne Shqiperi po ndjek ne menyre te pashmangshme kurben e tranzicionit epidemiologjik. Ne kete kuader po vihet re nje rritje e theksuar e risqeve te lidhura me menyren e re te jeteses, c'ka sjell nje dominim te semundshmerise dhe vdekshmerise se lidhur me semundjet kronike jo-infektive, si semundjet kardiovaskulare dhe kanceri. Gjithashtu, aksidentet automobilistike dhe traumat po behen dalengadale nje nga shkaqet kryesore te vdekjeve tek shqiptaret. Edhe vdekjet dhe lendimet nga aktet e dhunshme ne shoqeri dhe brenda familjes kane nje efekt negativ mbi statusin shendetesor te popullsise shqiptare. Se fundi, semundjet ngjitese vazhdojne te mbeten ende nje shqetesim serioz per shkak te infrastrukturove se varfer higjeno-shendetesore (uji i pijshem, mbeturinat, pakesimi i siperfaqeve te gjelbera etj.).

### 6.1.2 Problemet

Ne menyre te permbledhur sfidat e shendetit publik shqiptar sot jane:

- Semundjet kardiovaskulare te zemres dhe kanceret
- Aksidentet e trafikut ne rritje te shpejte
- Dhuna ne shoqeri e brenda familjes
- Shendetit Mendor – vetevasjet, perdonimi i drogave dhe alkoolit
- Semundjet ngjite se perfshi HIV/AIDS, semundjet seksualisht te transmentueshme, semundjet diarrheike etj.

### **6.1.3 Objektivi**

Te ruajme e te permiresojme shendetin publik te popullates nepermjet zbatimit te masave me efekt te per gjithshem.

### **6.1.4 Strategjite**

- a. Do te zhvillojme fushata “agresive” te promocionit shendetesor te fokusuarve vecanerisht ne permiresimin e stilit te jetes, parandalimit te aksidenteve automobilistike e akteve te dhunes, drogave, alkoolit etj.
- b. Do te fuqizojme kapacitetet kombetare ne fushen e promocionit shendetesor te cilat jane ende te dobeta. Kontributi i Shkolles se Shendetit Publik dhe Menaxhimit Shendetesor me kurrikulat perkatese ne kete fushe do te jete i rendesishem ne kete drejtim.
- c. Nga pikepamja organizative, perjegjesia e funksioneve te shendetit publik do te mbahet ne nivel qendror/rajonal te cilat sigurojne implementimin e programeve kombetare te shendetit. Organet e zgjedhura lokale i sherbejne shendetit te komunitetit qe qeverisin, duke zgjidhur problemet e:
  1. sigurimit te ujit te pijshej e higjenikisht te paster
  2. largimit dhe perpunimit te mbeturinave te ngurta,
  3. evakuimit dhe trajtimit te ujrate te zenza dhe te bardha,
  4. ndotjes se mjediseve urbane dhe rurale
  5. krijimit te siperfaqeve te gjelbera
  6. si edhe duke ndikuar ne problemet sociomjekesore si duhanpirja, alkolizmi, perdonimi i drogave etj.

## **6.2 KUJDESI SHENDETESOR PARESOR**

### **6.2.1 Situata**

Sherbimet e Kujdesit Shendetesor Paresor, duke qene pikë e pare e kontaktit te pacientit me sherbimin shendetesor, janë baza mbi te cilat mbeshtetet sistemi shendetesor. Ne vendet e zhvilluara te botes ku ky model funksionon mire, keto sherbime zgjidhin deri ne 90% te problemeve shendetesore te popullates. Kujdesi paresor ne Shqiperi ofrohet permes nje rrjeti ekstensiv te perbere nga qendra shendetesore urbane dhe rurale si edhe nga ambulanca fshatash. Ky rrjet ofron sherbimet e kujdesit mjekesor baze si edhe nje pakete programesh parandaluese, vecanerisht ato te imunizimit dhe te shendetit riprodhues. Sherbimet e kujdesit paresor sigurohen nga rreth 1500 mjeke te familjes dhe pediater si edhe nga nje numer me i madh infermjeresh dhe mamish. Numuri i mjekeve te familjes per 1000 banore ne vendin tone (1.3) eshte mjaft me i ulët jo vetem ne krahasim me vendet e Komunitetit European (3.9) por edhe me vendet ish – socialist (2.5).

Ministria e Shendetesise e ka konsideruar me perparesi sektorin e sherbimeve te kujdesit paresor dhe reforma e derimesotme shendetesore ka synuar mbrojtjen dhe fuqizimin e ketyre sherbimeve. Keshtu, perfshirja e mjekeve te per gjithshem, qe ofrojne sherbime ne kete nivel, ne skemen e sigurimeve te

kujdesit shendetesor synonte pikerisht krijimin e stimujve per te permiresuar aksesibilitetin si edhe per te rritur cilesine e ketyre sherbimeve. Nga ana tjeter, investimet e Qeverise se Shqiperise nga buxheti i shtetit si edhe nga fondet e donatoreve te rendesishem ne infrastrukturen e ketyre sherbimeve kane qene te rendesishme dhe kane sjelle padyshim impaktin e vet ne kujdesin shendetesor paresor. Sherbimi shendetesor paresor, meqjithe veshiresite, ka treguar dinamizem ne zbatimin e programeve shendetesore egzistuese, si psh programin e imunizimit, apo edhe ne futjen e programeve te reja si psh programin e planifikimit familjar apo programin pilot te shendetit mendor.

Pavaresisht nga rritja e ndjeshme e te ardhurave te mjekeve te per gjithshem, nuk eshte zgjidhur ceshtja e aksesit gjeografik per sherbimet mjekesore baze. Vazhdon te kete zona dhe fshatra, vecanerisht ne veri dhe veri-lindje te vendit, te cilat nuk e kane te siguruar sherbimin e nevojshem mjekesor. Jemi te vetedijshme se rritja e te ardhurave te mjekeve nuk eshte faktori i vetem, qe do te mund te zgjidhete problemin e mbulimit me personel mjekesor te zonave te thella rurale.

Nga informacionet qe ka Ministria e Shendetesise si edhe nga anketat e realizuara ne zona te ndryshme te vendit, rezulton se nje pjese e popullsise, nuk eshte e kenaqur me cilesine e sherbimeve mjekesore qe ofrohen ne kete nivel, vecanerisht komunitetet e zonave rurale. Kjo lidhet me mungesat ne pajisjet dhe materialet mjekesore diagnostike dhe kurative, me mungenen e sherbimit 24-oresh te urgjences, si edhe me pagesat qe nje pjese e njerezve jane te shtrenguar te kryejne ne menyre informale. Gjithashtu, meqjithe investimet e kryera ne infrastrukturen e qendrave shendetesore, perseri funksionimi i tyre mbetet problematik per shkak te mungesave ne furnizimin me uje dhe energji elektrike, sistemet e mangeta te kanalizimeve apo demtimet e aparaturave te pakta mjeksore.

Tradisionalisht ne Shqiperi sherbimi shendetesor eshte dominuar nga sherbimi spitalor. Eshte i njojur fakti se perdoruesit e sherbimeve preferojne shpesh qe te drejtohen tek specialisti, pa kaluar permes mjekeve te per gjithshem e te familjes. Edhe pagesat e futura per te dekuruar kete kapercim duket se nuk kane dhene resultatin e pritur. Kjo sjell nje shfrytezim te pamjaftueshem te sherbimeve te kujdesit mjekesor baze dhe nje mbingarkim te sherbimeve dytesore ambulatore dhe spitalore, te cilat jane me te kushtueshme.

Produktiviteti i ulet i personelit te kujdesit mjekesor paresor lidhet jo vetem me kerkesen e ulet per keto sherbime nga ana e popullsise, por edhe me nje seri faktoresh te tjere si financimin e pamjaftueshem dhe te fragmentuar; mungenen e autonomise menaxheriale nga ana e personelit te qendrave shendetesore; personelin e patrajnuar ne menyre te vazhdueshme dhe te pamotivuar etj.

## 6.2.2 Problemet

**Çeshtjet kryesore ne fushen e kujdesit shendetesor paresor mund te permblidhen si me poshte:**

- Aksesi i popullsise per sherbimet e kujdesit shendetesor paresor eshte i kufizuar ne zona gjeografike te caktuar te vendit dhe vecanerisht ne zona te thella rurale. Mungesa e personelit ne keto zona dhe transporti i veshtere drejt qendrave ku ofrohet sherbim mjekesor perbejne ceshtje te rendesishme te cilat kerkojne vemendje te vecante.
- Mitmarrja (pagesat informale) eshte nje fenomen i perhapur e shqetesues i cili pengon aksesin e popullates (sidomos shtresat ne nevoje) per sherbim shendetesor.
- Mungesa e autonomise se sherbimit te kujdesit paresor. Autonomia e shoqeruar me nje financim me te mire te ketij sherbimi do te permiresoje ndjeshem menaxhimin e sherbimit shendetesor paresor dhe do te ndikoje ne ndryshimin e perceptimit te popullates per kete sherbim. Me qellim qe efekti mbi keto perceptime te perforkohet, Ministria e Shendetesise do te organizoje ne vazhdimesi informimin dhe edukimin e popullsise per reformen e kujdesit shendetesor paresor si edhe rendesine dhe mundesite qe ofron ky sherbim.

- Cilesia e dobet te sherbimeve shendetesore paresore, ç'ka ndikon edhe ne perdonimin e paket te tyre. Permiresimi i aresyeshem i cilesise se sherbimeve te kujdesit paresor perben nje perparezi te rendesishme dhe nje nga drejtimet kryesore te strategjise se zhvillimit te sektorit shendetesor. Masat qe synojne ngritjen e cilesise se sherbimit do te perfshijne edhe permiresimin e infrastruktureve dhe te funksionimit normal te tij (furnizim me uje dhe energji elektrike, sisteme te pershtatshme te evakuimit te ujrate te bardha dhe te zeza, sisteme efikase te eliminimit te mbeturinave etj.). Ne kete drejtim, angazhimi i pushtetit lokal dhe e komuniteteve perben nje domosdoshmeri.
- Mungesa e mekanizmave te shperblimit me motivues e me te matshem nga pikepamja sasiore e cilesore. Financimi i sherbimit te kujdesit shendetesor paresor me ane te skemes se sigurimit shendetesor eshte nje arritje e madhe. Ministria e Shendetesise e Instituti i Sigurimit te Kujdesit Shendetesor duhet te perpunojne skema te tilla shperblimi te cilat te stimulojne permiresimin e aksesit dhe te cilesise se sherbimit shendetesor qe i ofrohet popullates.
- Trajnim i pamjaftueshem dhe jo rralle here i pastandardizuar i personelit mjekesor (kjo e fundit vlen per infermjeret dhe mamite) ndikon ndjeshem ne cilesine e sherbimeve dhe rezultatet e trajtimit.
- Mungesa e nje sistemi kreditimi te mjekeve e te personelit tjeter shendetesor te lidhur ngushte me procesin e edukimit te vazhdueshem dhe licensimin profesional pengon procesin e freskimit te njojurive duke ulur ndjeshem nivelin e tyre profesional e cilesine e sherbimit shendetesor.

### **6.2.3 Objktivi**

Do te forcohet sherbimi i kujdesit shendetesor paresor per te realizuar potencialin e tij ne funksion te permiresimit te aksesit e cilesise se sherbimit ndaj popullates e menaxhimit me efektiv te burimeve te disponueshme.

### **6.2.4 Strategjite**

- Do te permiresohet aksesi i popullates per sherbimet e kujdesit paresor shendetesor nepermjet:
- futjes se mekanizmave te reja me stimuluese te shperblimit te diferencaj sipas sasisë dhe cilesise se sherbimit
- pranise permanente te personelit te mesem te kualifikuar, qe do te siguroje sherbimet shendetesore baze;
- sigurimit te transportit ne rastet e urgjencave mjekesore nga zonat e thella rurale;
- disponibilitetin 24 oresh te mjekeve te familjes, te parashikuar ne kontratat e tyre me sigurimet shendetesore;
- afruit prane komuniteteve te sherbimeve qe nuk kane egzistuar tradicionalisht ne nivelin e kujdesin paresor dhe per te cilat popullsia eshte teper e interesuar, si psh. sherbimet diagnostike laboratorike ne qendrat e medha shendetesore;
- Do te permiresohet ndjeshem cilesia e sherbimit nepermjet;
- Institucionalizimit te trainimit te vazhdueshem te profesionisteve te kujdesit shendetesor paresor. Qendra Kombetare e Trainimit te Vazhdueshem Shendetesor e cila do te planifikoje e realizoje forcimin e kapaciteteve profesionale te te gjithe profesionisteve te shendetesise.
- Vendosjes se sistemit te kreditimit te detyrueshem. Brenda vitit 2005 do te vendoset nje sistem akreditimi i detyrueshem profesional per te gjithe profesionistet.
- Permiresimit te ndjeshem te infrastruktureve se sherbimit shendetesor paresor duke aplikuar menaxhimin autonom te tyre si edhe duke bere koordinimin me me efektivitet me pushtetin vendor.
- Do te permiresohet financimi i sherbimit te kujdesit shendetesor paresor nepermjet:

- Shtimit te financimit nga buxheti eshte peraktuar si prioritet ne SKZHES.
- Zgjerimit te bazes dhe shtimit te kontributeve te skemes se sigurimit te kujdesit shendetesor.
- Futjes se bashkepageses per sherbime te vecanta e te studiuara mire.
- Do te fuqizohet e persoset menaxhimi i sistemit shendetesor paresor nepermjet zgjerimit dhe forcimit te autonomise se sherbimit paresor duke synuar drejt skemes “financim publik e sherbim autonom (privat)”. Ne kete skeme sherbimet e kujdesit paresor do te ofrohen nga dy entitete autonome; grupi i praktikes shendetesore autonome dhe mjeku i familjes. Te dyja keto forma te organizimit te sherbimeve do t'i nenshtrohen te njejtave standarde te praktikes klinike dhe te cilesise. Brenda vitit 2004 do te perpiloheshet dhe diskutohet paketa e sherbimeve shendetesore, qe do te financohet nga fondi i sigurimeve shendetesore. Paketa e sherbimeve do te rishikohet dhe do te pershtatet ne vazhdimesi nga autoritetet shendetesore rajonale. Ministria e Shendetesise do te hartoje paketen fillestare te sherbimeve, deri ne momentin e krijimit te autoriteve shendetesore rajonale. Pagesa do te jete e kombinuar, per fryme (per capita) dhe per sherbim (fee for service) me numer limit (tavan) sherbimesh.

#### **Avantazhet e kesaj skeme jane:**

- Perdorim me efektiv fondesh
- Rrit konkurrencen
- Sjell produktivitet me te larte
- Permireson aksesin e cilesine e sherbimit
- Permireson informacionin shendetesor (behet i domosdoshem pasi perdoret per efekt pagese).

Dizavantazhi i vetem eshte se kerkon kapacite te larta monitorimi e kontrolli e sisteme informacioni te besueshme nga ISKSH dhe Autoritetet Shendetesore Rajonale. Ky model ne thelb zbaton rregullat e ekonomise se tregut prandaj do te fillohet ne qytetet e medha ku edhe kushtet e realizimit jane me te mira.

- Do te hartohen dhe do te botohen brenda vitit 2005 udhezuesit e praktikes klinike nga Urdheri i Mjekeve, ne bashkepunim me Shoqaten e Mjekeve te Familjes. Keto udhezues do te perfshijne edhe protokolle standarte te mjekimit, te cilat do te ndikojne ne permiresimin e cilesise se trajtimit te te semureve si edhe ne mbajtjen ne kontroll te kostove te ketij trajtimi.
- Do te ruhen, shtrihen dhe fuqizohen programet e shendetit publik si psh. programi i zgjeruar i imunizimit, programi i shendetit riprodhues (planifikim familjar, memesi e sigurte, kujdesi i foshnjeve te posalindura), programet e luftes kunder infeksioneve respiratore akute dhe semundjeve diarrheike, programi i luftes kunder tuberkulozit e i shendetit mendor. Keto programe do te jene te integruala me sherbimet mjekesore baze dhe do te ofrohen permes ekipeve te mjekeve dhe infermijereve qe do te operojne ne menyre autonome.

## **6.3 SHERBIMET E KUJDESIT SHENDETESOR SPITALOR**

### **6.3.1 Situata**

Sherbimet mjekesore dyesore ofrohen nga 50 spitale si edhe nje rrjet poliklinikash te specializuara, publike dhe private, te cilat gjenden kryesisht ne zonat urbane. Numri i shtreteve ne raport me popullsine ishte 3,1/1000 banore, qe perben nje nga shifrat me te uleta te rajonit europian. Shfrytezimi i shtreteve spitalore ne nivel kombetar ishte 50,5% (2002). Ky tregues eshte teper larg mesatares se vendeve te Europees Qendore dhe Lindore, (72,8%) dhe mesatares se vendeve te Europees Perendimore, (77%) ne vitin 2000 . Keto shifra tregojne se spitalet e Shqiperise kane nje shkalle te ndjeshme nen-shfrytezimi. Nderkohe, dite-qendrimi mesatar ne spitalet e vendit tone paraqet nje mesatare prej 6,7 ditesh, e cila gjithashtu eshte me e ulet se mesatarja e Europees Perendimore (8,2) dhe ajo e vendeve te Europees

Qendrore-Lindore (8.3) shifera keto te vitit 1998.

Sherbimet e specializuara ambulatore dhe spitalore ndeshin ne shume pengesa lidhur me dhenien e sherbimeve cilesore ndaj pacienteve dhe konsumatoreve. Sherbimi spitalor ka trasheguar nje infrastrukturte teper te dobet. Gjithashtu, edhe gama e sherbimeve te ofruara nuk ka perfshire te gjitha sherbimet e specializuara diagnostike dhe kurative, duke bere qe patientet shqiptaret te drejtohen historikisht jashte vendit te tyre. Gjate viteve te fundit, Ministria e Shendetesise ka bere investime te rendesishme ne sektorin spitalor, si ne permiresimin e infrastruktures se tij, ashtu edhe ne permiresimin e teknologjive. Megjithate infrastruktura spitalore eshte ende nen standartet e deshiruara. Nje rol negativ ne kete drejtim luan edhe mjesidi ne te cilin ndodhen spitalet dhe qe nuk kontrollohet drejtperdrejt nga sektori i shendetesise. Keshtu, furnizimi me nderprerje i energjise elektrike dhe ujit te pijshem ka padyshim nje impakt serioz ne punen e sherbimeve spitalore.

Sektori spitalor publik akoma nuk u ofron pacienteve dhe konsumatoreve te gjithe gamen e sherbimeve diagnostike dhe kurative. Nga ana tjeter, ende nuk eshte zhvilluar nje sistem spitalor privat, i cili do te ofronte nje alternative sherbimesh diagnostike dhe kurative brenda vendit, kundrejt pagesave te drejtperdrejta nga pacienti. Vetem ne kryeqytet dhe ne ndonje qender tjeter te madhe urbane jane hapur dhe po funksionojne sherbime te specializuara ambulatore private, me ose pa qellim fitimi, te cilat kane kushte teper te mira infrastruktura dhe jane te pajisura me teknologji te nivelit te larte. Meqenese shumica e sherbimeve private ofrohen kundrejt pagesave nga pacienti, atehere ato mund te perballohen vetem nga nje pjese e popullsise. Ne kete drejtim ndikon edhe mungesa e mbulimit te kostos se ketyre sherbimeve nga skema e sigurimeve shendetesore. Meqenese spitalet shteterore dhe klinikat ambulatore private nuk arrijne te plotesojne te gjitha nevojat e pacienteve, keta te fundit detyrohen t'i kerkojne dhe t'i marrin keto sherbime ne vendet fqinje si Turqia, Italia dhe Greqia, me nje kosto te larte per familjet e tyre. Per pasoje kemi edhe rrjedhje jashte vendit te burimeve te pakta financiare te popullsise.

Financimi i spitaleve behet nga buxheti i shtetit me linje buxheti historike, menyre kjo qe nuk stimulon perdonimin eficient te burimeve. Perpjekjet per te bere financim sipas nevojave reale kane hasur veshtiresi per mungese te kapaciteteve teknike. Gjate vitit 2003 per spitalet eshte shpenzuar 65% e buxhetit total te shendetesise. Perpjekjet per financimin e sherbimit nga skema e sigurimit shendetesor jane ende ne fillesat e saj. Financimi eshte i pamjaftueshem dhe per rrjedhoje, spitalet nuk jane ne gjendje t'u ofrojne te semureve sherbime te pershtatshme, ne perputhje me kerkesat dhe standartet e kohes.

Pagesat nen-dore perbejne nje shqetesim serioz per Ministrine e Shendetesise. Kjo dukuri lidhet me te ardhurat e pamjaftueshme te mjekeve dhe te personelit tjeter te sherbimeve mjekesore si edhe me nje mentalitet te perhapur se fundi ku cdo sherbim konsiderohet si mall, per te cilen je i shtrenguar te paguash, nese deshiron te perfitosh cilesine e deshiruar. Aresyet per keto pagesa jane kerkesat apo sugjerimet indirekte nga ana e mjekeve, deshira e vete pacienteve apo edhe frika e ketyre te fundit se mos sherbimet e ofruara nuk do te ishin te nivelit te deshiruar.

Megjithe perpjekjet e bera kohet e fundit, menaxhimi i dobet mbetet ceshtja me e mprehte qe ndikon ne performancen dhe cilesine e sherbimeve ne spitalet tonë. Ende vazhdon mentalitetit tradicional i menaxhimit te spitaleve nga kliniciste te njohur te cileve u mungon edukimi baze menaxherial. Kjo manifestohet qarte edhe ne strukturat organizative te spitaleve te cilat jane te njehshme e te mangeta (me polin teknik te zhvilluar e ate menaxherial te manget). Nga ana tjeter, keta specialiste konsumojne nje pjese te madhe te kohes ne punen klinike me te semuret keshtu qe praktikisht jane menaxhere "part-time" te ketyre institucioneve me kaq probleme. Klinicistet ne thelb interesohen per trajtimin sa me cilesor te patientit e kjo jo rralle bie ndesh me frymen e nje menaxhimi te rrepte te burimeve financiare pasi del edhe mbi standartet e percaktuara. Edhe decentralizimi i manget brenda institucional ndikon negativisht ne mbarevajtjen e institucionit. Mungojne modele te menaxhimit modern te spitaleve. Sistemet e informacionit klinik e financier qe jane baza e ketyre modeleve, jane me teknologji e metodika te vjeteruara e me staf pak te trainuar. Burimet financiare te pakta, te kombinuara me efekte te menaxhimit jo profesional te spitaleve ndikojne se tepermi mbi produktivitetin dhe cilesine e sherbimeve. Sidoqofte, mungojne te dhena te sakta mbi keto te fundit, meqenese ende nuk eshte ngritur nje sistem monitorimi, i cili do te vezhgonte dhe do te maste performancen spitalore.

Cilesia e sherbimeve spitalore ndikohet se tepermi edhe nga personeli i spitaleve. Megjithe perpjekjet e bera

dhe punen e vazhdueshme per t'i ofruar kujdes te mire pacienteve dhe konsumatoreve, personeli spitalor nuk eshte i motivuar. Kjo lidhet me te ardhurat e pamjaftueshme, mungenes e formimit profesional te vazhduar, mjedisin e punes me mungesa si edhe menaxhimin e papershtatshme te burimeve njerezore.

Sherbimi spitalor ka mungesa te rendesishe ne teknologjite e reja diagnostike dhe kurative. Kjo vjen si pasoje e burimeve financiare te pamjaftueshme per te realizuar investime te rendesishe ne teknologjite e mjekesore. Edhe ne rastet kur investimet arrijne te realizohen, ndeshen veshtiresi te tjera qe lidhen me buxhetet e kufizuara operative, te cilet nuk lejojne funksionimin optimal te ketyre teknologjive. Nje ndikim negativ ne kete drejtim luan edhe mungesa e standarteve kombetare te teknologjive spitalore, egzistencia e te cilave do te conte ne nje shperndarje me racionale te ketyre teknologjive, duke disiplinuar edhe donacionet e huaja, nganjehere irrationale.

Forcimi i kapaciteteve te mirembajtjes se pajisjeve spitalore mbetet nje aspekt i rendesishem i nderhyrjeve ne sektorin spitalor. Megjithë investimet e rendesishe qe jane realizuar ne te shkuaren, sektori bio-inxhinierik akoma nuk ka arritur t'i perqigjet te gjitha kerkesave dhe nevojave te sherbimeve spitalore. Ky sektor vuani nga mungesa e personelit, demotivimi i tij per shkak te te ardhurave te pakenaqshme, trajnimit te pamjaftueshme te ketij personeli dhe aparaturat e pakta ne oficinat e mirembajtjes. Ministria e Shendetesise ka synuar vazhdimesh qe te konceptoje dhe te ndertoje ne praktike nje sistem te organizuar bio-inxhenjerik ne nivel kombetar, duke futur edhe shume elemente te tregut ne funksionimin e tij, ç'ka do te nxiste cilesine dhe vazhdimesine ne funksionimin e tij.

Aktualisht, nuk egzistonje protokolle te sakta per trajtimin e te semureve. Shoqatat profesionale te mjekeve si edhe vete Urdheri i Mjekeve nuk kane arritur te formulojne protokolle mjekimi, per te cilat do te kishte nje konsensus te plote nga ana e mjekeve. Egzistenca e ketyre protokolleve do te kishte nje efekt pozitiv ne trajtimin e te semureve, ne percaktimin e sakte te kostos se trajtimit te patologjive te ndryshme si edhe ne planifikimin me racional te nevojave per barna ne spitalet e vendit dhe rrjedhimisht, edhe ne nje disponibilitet me te madh te barnave neper spitale.

### 6.3.2 Problemet

- Numer i vogel, shperndarje e pabarabarte dhe shfrytezim i ulet i shtreterve spitalore.
- Infrastrukture spitalore ende e dobet.
- Financim i pamjaftueshem, skemat e sigurimit shendetesor ende te pa perfshira ne financimin e sherbimit.
- Pagesat nen-dore shqetesim serioz qe demtojne aksesin e popullates.
- Mungesa e autonomise se spitaleve.
- Menaxhim joprofesional, me strukture organizative te njeanshme, mungojne modelet e menaxhimit e sistemet e infromacionit modern.
- Teknologji e pastandartizuar, politikat e mirembajtjes jo efektive.
- Mungese e sistemeve te akreditimit te spitaleve
- Rrjedhje e fondeve drejt sherbimeve spitalore te vendeve fqinje.
- Motivim i pamjaftueshem i personelit.

### 6.3.3 Objektivi

Te arrijme nje akses te mire, cilesi te kenaqeshme dhe menaxhim kosto – efektiv te sherbimit spitalor.

### 6.3.4 Strategjite

- 1) Do te hartohet brenda vitit 2004 plani kombetar i sherbimit spitalor ne Shqiperi, ku do te percaktohet qarte shperndarja e sherbimeve spitalore dhe niveli i spitaleve sipas zonave te ndryshme gjeografike (spitalet e rrethit, te rajoneve dhe sherbimet universitare) te sankzionuar edhe ne ligjin e spitaleve.

- 2) Do te rikonfigurohen sherbimet spitalore ne Tirane. Do te planifikohet dhe do te filloje brenda vitiit 2005 ngritja e një spitali rajonal per Tiranen, me qellim qe te lehtesohen sherbimet terciare te QSUT-se. Ngritja e spitalit rajonal te Tiranes do te shoqerohet me një reduktim gradual te numrit te shtreterve ne QSUT, ne menyre qe te lehtesohet menaxhimi i kesaj strukture dhe te shfrytezohet vetem per nderhyrje terciare..
- 3) Do te permiresohet menaxhimi i spitaleve. Per kete do te krijohen gradualisht spitale autonome, te drejtuara nga borde spitalore me perberje te gjere nga te gjithe aktoret e interesuar (perfshire edhe perfaquesues te interesave te pacienteve) dhe te administruara nga menaxhere profesioniste. Per kete
- a. Do te krijohen modele moderne te menaxhimit eficient,
  - b. Do te permiresohen strukturat organizative te spitaleve duke i bere ato dypolare; poli mjekesor dhe ai menaxherial,
  - c. Do te fuqizohen e modernizohen sistemet e informacionit spitalor,
  - d. Do te krijohen mekanizma per një decentralizim me fuksional brendaspitalor,
- Autonomia menaxheriale e spitaleve do te kerkoje domosdoshmerisht fuqizimin e procedurave te transparencës dhe te dhenies se llogarise. Perpunimi i mekanizmave te kesaj forme te re te organizimit dhe menaxhimit do te kerkoje mbeshtetje te rendesishme teknike dhe shkembim pervoje me spitale te vendeve me te zhvilluara, qe kane kaluar permes proceseve te ngjashme.
- 4) Do te krijohet sistemi kombetar i akreditimit spitalor si një mekanizem eficient ne monitorimin periodik te kapaciteve teknike e njerezore per te realizuar funksionin e tyre sipas standarteve.
- 5) Do te perpunohet mekanizmi i ri i financimit te sherbimeve spitalore nga skema e sigurimeve shendetesore brenda vitit 2007 me qellim qe te synohet permiresimi i performances se spitaleve dhe shfrytezimi optimal i burimeve egzistuese (shih financimin e sherbimeve). Ne kete menyre, financimi i spitaleve do te behet nepermjet:
- a. fondeve te Ministrise se Shendetesise per investime kapitale ne infrastrukturre dhe pajisje,
  - b. skemes se sigurimeve shendetesore si burimi kryesor i financimit te sherbimit,
  - c. bashkepagesa (te studiuara me shume kujdes), te cilat do te kontribuojne ne mosabuzimin me burimet,
  - d. pagesave te drejtperdrejta nga xhepi te pacienteve per sherbime te vecanta (kozmetike etj.).
- 6) Do te nxitet dhe do te mbeshtetet procesi i shtrirjes te praktikes se ligjshme private ne dhenien e sherbimeve spitalore. Kjo do te zgjeroje gamen e sherbimeve cilesore te ofruara ne Shqiperi dhe do te pakesoje kerkimin e sherbimeve te specializuara shendetesore jashte vendit. Njekohesisht, krijimi i një sektori te konsoliduar privat, do te krijonte kushte te pershtatshme per ngritjen e sigurimeve shendetesore private.
- 7) Do te hartohen dhe do te filloje aplikimi i protokolleve standarte te trajtimit dhe i udhezuesve te praktikes klinike. Kjo do te realizohet nga vete mjeket specialiste, te koordinuar nga Urdheri i Mjekeve dhe me perfshirjen e shoqatave te tyre profesionale. Njekohesisht, Qendra Kombetare per Formimin e Vazhduar Profesional do te beje te mundur rifreskin e njoburive dhe futjen e koncepteve bashkekohore ne praktiken klinike te sherbimeve tonë dytesore, ambulatore dhe spitalore. Protokollet standarte si edhe procesi i trajnimit te vazhduar janë kushte te domosdoshme per rritjen e profesionalizmit ne mjekesi si edhe per permiresimin e cilesise se sherbimeve spitalore.
- 8) Do te rriten te ardhurat e personelit te spitaleve permes ndertimit te marredhenieve kontraktuale midis administrates autonome spitalore dhe te punesarve te ketyre institucioneve. Perfshirja e spitaleve ne skemen e sigurimeve shendetesore dhe dhenia e autonomise menaxheriale do te beje te mundur një permiresim te ndjeshem te pagesave te personelit, duke kerkuar prej tyre rritje te ndjeshme te produktivitetit ne pune. Kjo reforme mund te sjelle nevojen e shkurtimit dhe rishperndarjes se personelit te spitaleve.

9) Do te fuqizohen kapacitetet per standartizimin dhe mirembajtjen e aparaturave dhe pajisjeve spitalore.

Do te hartohet nje plan per racionalizimin e aparaturave dhe pajisjeve mjekesore ne shkalle vendi. Ky proces do te shoqerohet edhe me perpilimin e standarteve dhe specifikimeve teknike te ketyre aparaturave. Racionalizimi dhe standartizimi do te realizohen ne bashkerendim te ngushte me procesin e planifikimit kombetar te sherbimeve spitalore dhe do te ndikojne ndjeshem ne shperndarjen kosto-efektive te aparaturave, ne varesi te tipit te spitaleve (rrethi, rajoni apo universitar), si edhe ne perputhje me sherbimet qe do te ofrohen ne keto spitale. Standartizimi duhet te perfshije edhe nje harmonizim sa me te madh me Direktivat e Aparaturave Mjekesore te Bashkimit Europian. Krahas me procesin e racionalizimit te pajisjeve, do te forcohen kapacitetet bio-mjekesore te mirembajtjes se aparaturave ne rang vendi. Ne kete kuader do te kete nje impakt te madh realizimi i projektit (me Seedish Health Care) per forcimin e kapaciteteve te standartizimit dhe mirembajtjes se aparaturave ne nivel kombetar e rajonal.

10) Do te hidhen hapat e para drejt ngritjes se nje « sistemi te sigurimit te cilesise se sherbimeve spitalore ».

Kjo do te behet e mundur permes ndertimit te nje paneli treguesish te performances spitalore, te cilet do t'i lejojne menaxhereve te spitaleve te orientojne masat e tyre per forcimin e cilesise. Ndertimi i nje sistemi te tillë do te realizohet me mbeshtetje teknike persa i perket konceptimit te tij si edhe permes investimeve per fuqizimin dhe shtrirjen e infrastruktureve informatike ne sherbimet tona spitalore.

## 6.4 SHERBIMI STOMATOLOGJIK

### 6.4.1 Situata

Sherbimi stomatologjik eshte i organizuar ne sherbimin publik dhe privat. Raporti midis ketyre dy sherbimeve eshte afersisht 30% me 70% ne favor te sherbimit privat.

Sherbimi publik ka nisur te organizohet ne baze te nje reforme e cila mbeshtetet ne nje dokument politik, "Strategjia e Shendetit Oral per Shqiperine"(2000) qe konsiston ne organizimin e nje sherbimi me karakter profilaktiko- kurativ ne perputhje dhe me rekomanimet e OSH. Kjo reforme ka cuar ne organizimin e ketij sherbimi ne qendra te parandalimit, te organzuara neper shkolla dhe ne punkte dentare te perqendruara ku dhe jane grumbulluar te gjithe mjeket stomatologe. Ne keto qendra ushtrojne aktivitetin publik edhe ndihmes mjeket stomatologe dhe mjeket e rinj te sapodiplomuar qe kryejne stazhin 2 vjecar.

Sherbimi privat ushtrohet ne klinikat private te perqendruara kryesisht ne Tirane (rreth 900 te tillë) dhe qytetetet tjera te medha. Nivelii organizimit dhe sherbimit te ketyre klinikave, duke vleresuar kushtet higjeno-sanitare, kushtet fiziko-ambjentale, cilesine e aparaturave dhe materjaleve te perdonura, profesionalizmin e mjekve stomatologe etj, variojne nga me te modernet dhe cilesoret, deri tek ato me nje sere mangesish dhe problemesh, duke j'u referuar te gjithe parametrave te licensimit. Gjithashtu nje problem jane cmimet e larta dhe te pastandartizuar te sherbimeve te ofruara, shpesh here te paperballueshme per popullaten.

### 6.4.2 Problemet

- Egzistencia e 30% te sherbimit shteteror (per femijet deri ne 18 vjec), krijon shteg per abuzime,
- Funksionet parandaluese te nenvleftevara e jo efektive,
- Shperndarje e pabarabarte e sherbimit duke krijuar veshtire aksesi ne zonat rurale,
- Mungesa e aparaturave apo aparatura qe nuk permbushin standartet per nje trajtim adekuat te femijeve,
- Gjendje e amortizuar e disa qendrave qe sherbejne si punkte dentare,
- Tregu i sherbimit eshte i pakontrolluar persa i perket cmimeve,
- Probleme higjeno – sanitare, gjendjen fizike dhe rregullat teknike te disa klinikave dentare private,
- Mungesa e skemave te sigurimit shendetesor ne sherbimin stomatologjik.

### **6.4.3 Zgjidhjet e propozuara:**

- Permireshimi i ligjishmerise per te harmonizuar reformimin.
- Krijimi i hartes kombetare te sherbimit dentar brenda vitiit 2004.
- Privatizimi i pote i sherbimit kurativ dentar dhe mbulimi i sherbimeve te moshes 0-18 vjec nga skema shteterore e sigurimeve shendetesore. Publike te mbetet vetem profilaksia (depistimi, edukimi e promociioni) e cila te realizohet me shume seriozitet.
- Te vendosen cmime tavan te percaktuara nga ekspertet dhe te ekspozuara dukshem ne klinikat dentare. Keto cmime jane domosdoshmeri per futjen e skemave te sigurimeve ne sherbimin dentar.
- Te percaktohen me ane te nje grapi ekspertesh, cmimet dysheme te sherbimeve dentare, te vlefshme per cdo klinike stomatologjike.
- Monitorim e kontroll i rrepte nga strukturat e inspektimit te aktivitetit me penalizime te ashpra per shkelesit e rregullave.
- Te inkurajohen skemat private te sigurimit shendetesor

## **6.5 SHERBIMI FARMACEUTIK**

### **6.5.1 Situata**

Ne fillim te viteve '90 sektori farmaceutik u ndodh ne kolaps te pote. Prodhimi e shperndarja u bllokuan dhe nevojat e vendit u mbuluan kryesisht me ndihmat humanitare. Gjendja e krijuar kerkonte nje reformim te sektorit per te realizuar kalimin e tij ne ekonomine e tregut si dhe zgjidhjen e problemeve jetike per pacientet.

Politika kombetare farmaceutike, pjese perberese dinamike e politikes shendetesore, gjate ketyre viteve ka synuar ne, sigurimin dhe perdomin racional te nje numri te mjaftueshem barnash efektive, te sigurta e me cilesi te larte, dhe qe te jene te disponueshme e me çmim te arritshem per te gjithe popullaten.

Prioritet per zbatimin e kesaj politike u percaktua privatizimi i sektorit. Ne fillim liberalizimi e pastaj privatizimi i rrjetit te hapur te farmacive, sot i privatizuar 100%, privatizimi i fabrikuesve, sot 100% dhe licencimi i aktiviteve farmaceutike private. Ne tregun farmaceutik sot operojne 3 fabrikues, 84 depo private (rreth 35 prej te cileve jane importues), nje depo shteterore (70 %) dhe 933 farmaci dhe agjenci farmaceutike. Ne zhvillimin e refomimit te sektorit, element i rendesishem ka qene riaktivizimi i industrise vendase dhe krijimi i kushteve per rritjen e prodhimit farmaceutik. Keshtu eshte realizuar se pari riaktivizimi i dy fabrikuesve ekzistues, pastaj privatizimi i tyre, duke u ruajtur baza prodhuese farmaceutike ne vend, si nje industri gjenerike me nje numer barnash qe perdoren gjeresisht ne sherbimin shendetesor. Po keshtu kjo industri realizon edhe eksportet duke ndikuar pozitivisht ne ekonomine kombetare.

Reformimi i sektorit dhe zbatimi i politikes kane sjelle permireshimet e deshiruara ne disa drejtime si furnizimi i tregut me shumellojshmerine e barnave, riaktivizimi i prodhimit vendas, regjistrimi i barnave, gjallerimi i shperndarjes me pakice te barnave, krijimi i bazes se re te informacionit per barnat dhe njekohesisht edhe probleme te reja e serioze.

### **6.5.2 Problemët**

- Monitorimi e kontrolli i dobet i prodhimit, ruajtjes dhe tregtimit te barnave. Numri i punonjesve ne strukturat e inspektoriatit farmaceutik eshte i pamjafueshem si pasoje jane shtuar edhe probleme te tillë si futja e barnave kontrabande dhe shitja e ndihmave humanitare sidomos ne periudhat e krizave,

moszbatimi i marzheve te fabrikimit dhe tregtimit.

- Mungesa e nje sistemi kombetar informacioni ne sektorin farmaceutik, qe te perfshije gjithe hallkat qe nga inspektimi, regjistrimi, informacioni per barnat dhe farmakovigilencen.
- Qarkullimi i barnave me etikete ne gjuhe te huaj jo te parashikuar ne rregulloren e regjistrimit; qarkullimi i barnave me flete informuese ne gjuhe te huaj edhe pas gjashte muajsh nga regjistrimi (sipas rregullores); mos venia e çmimeve ne etikete nga fabrikuesit dhe importuesit, duke u lene kjo detyre vetem per farmacistet.
- Abuzim me cmimet e barnave.
- Fabrikimi dhe tregtimi i barnave jo sipas rregullave te praktikes se mire.
- Mangesi ne legjislacionin aktual farmaceutik.
- Numri i pamjaftueshem i farmacisteve te diplomuar dhe diferencat e pagave ne tregun e punes midis sektoreve privat dhe shteteror, shoqeruar edhe me mungenen e stimulimit te punonjesve, ne ato institucione qe sigurojne te ardhura jo te vogla, kane penguar punesimin ne strukturat shteterore, duke i bere ato inekzistente.

### **6.5.3 Objektivi**

Krijimi i nje sherbimi farmaceutik qe do te sigurojne barna te sigurta, te mjaftueshme, me cilesi te kenaqshme e me cmime te pranueshme per popullaten.

### **6.5.4 Strategjite**

- a. Permiresim i legjislacionit farmaceutik duke marre per baze pervojen e Komunitetit European. Hartimi e miratimi i Dokumentit te Politikes Kombetare te Barnave brenda vitiit 2004.
- b. Forcim i kapaciteteve monitoruese dhe kontrolluese te prodhimit, ruajtjes dhe tregetimit te barnave. Riorganizimi i QKKB nepermjet miratimit te nje statusi te ri, forcimi i inspektimit dhe specializimi i tij, zgjerimi i aktiviteteve te QKKB nepermjet forcimit te strukturave te reja lidhur me informacionin e barnave, farmakovigilencen etj.
- c. Forcimi i strukturave te Urdhrit te Farmacisteve si nje partner i rendesishem ne ruajtjen e pastertise se te etikes profesionale.
- d. Thellimi i transparences se çmimeve te barnave, nepermjet permiresimit te sistemit te informacionit dhe vendosjes se çmimit ne etiketen ne gjuhen shqipe.
- e. Qarkullimi i barnave me etikete dhe flete informues ne gjuhen shqipe. Vendosja e pulles se kontrollit.
- f. Permiresim i kushteve teknike te farmacieve me synim arritjen e standardeve te vendeve te zhvilluara.
- g. Miratimi i dhe perdonimi i Praktikes se Mire te Fabrikimit, te Ruajtjes dhe Tregetimit te barnave.

# SUKSESI I REFORMES

## 7

Kjo Strategji permban ne thelb reformimin e sistemit te shendetesise, nje ndermarrje e veshtire por e domosdoshme, neqoftese duam qe ky sistem te jete bashkekohor. Me qellim qe te zbatohet ne menyre sa me te sukseshme, reforma e sistemit te shendetesise duhet te kete vecorite e meposhtme:

- Mirekuptimi dhe mbeshtetja e popullates. Popullata eshte objekti dhe subjekti i reformes, eshte ajo qe do te perfitoje nga implementimi i suksesshem i saj prandaj eshte e domosdoshme te realizohet nje fushate e gjere sqaruese e bindese duke shfrytezuar te gjitha mundesite, mediat e shkruara dhe elektronike, bisedat, takimet etj.
- Konsensusi i gjere. Nenkupton krijimin e sa me shume aleateve qe te mbeshtesin idete dhe zbatimin e reformes shendetesore, pasi eshte e kuptueshme qe kundershtaret e reformes do te jene te shumte. Tradisionalish, mjeket kliniciste jane kundershtare te ndryshimeve te medha si edhe partizane te ruajtjes se statukuose. Rrjedhimisht, eshte e nevojshme qe te pershihen sa me teper ne procesin e diskutimit dhe zbatimit te reformes, pasi shpesh here edhe thjesht perfshirja shhang mundesine e kundervenies. Njekohesisht, duhen bere per vete edhe perfaqesues te aktoreve te tjere te interesuar si ata te pushtetit lokal, organizatave te huaja multi- dhe bilaterale, mass-mediave, biznesit etj.
- Vullneti politik. Barren e rende te implementimit te reformave shendetesore nuk e mbajne dot “supet” e nje ministrie. Ato kerkon nje angazhimin te plote te forces politike qe drejton vendin dhe konsensusin e forcave te tjera. Per kete te ndertohet nje Komitet Politik i Reformes Shendetesore i cili te drejtoje politikisht kete reforme.
- Vazhdimesia. Te vazhdohen dhe te cohen me tej nderhyrjet e filluara reformuese. Njekohesisht, duhet te shfrytezohen ne maksimum dokumentat e nen-sektoreve te vecante te shendetesise, te hartuara vitet e fundit nga grupe ekspertesh apo konsulente te huaj. Kjo ka per qellim qe ndihma e huaj teknike te behet sa me efektive dhe te shmanget riformulimi i planeve dhe programeve, ne varesi te nderrimit te stafeve drejtuese.
- Vijueshmeria. Reforma duhet te realizohet me vazhdimesi dhe pa nnderprerje. Zvarritja apo nnderprerjet nuk bejne gje tjeter vecse diskreditojne elementet e reformes shendetesore. Per te siguruar persistencen e reformes shendetesore, duhet te krijohet nje Komision Drejtues i Reformes Shendetesore qe te ngarkohet me zbatimin e dokumentit te reformes, te miratuar nga Ministria e Shendetesise dhe Keshilli i Ministrave. Anetaret e grupit te jene perqejgjes per monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve te parashikuara sipas sektoreve perkates. Ecuria e aktiviteteve te raportohet rregullisht, me qellim qe te merren masat e nevojshme per kapercimin e pengesave apo zgjidhjen e problemeve te mundshme.